BASHKIA LEZHË

Plan Mbarështimi
Ekonomia Pyjore
"Brinjat e Kreshtës"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 5651 *prot.* *Lezhë, më:* 30-04 *2026*

URDHËR
Nr 302 **datë** 30-04 **2026**

Për
ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore Brinjat e Kreshtës, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë.

Në zbatim të ligjit nr.139 datë 17.12.2015" Për Vetëqeverisjen vendore", ligjit nr 57/2020 "Për Pyjet" neni 11, pika 2 germa b:

URDHËROJ

1 Ngritjen e grupit të punës si vijon:

1. Artan	Palushi	Kryetar
2. Ardit	Molla	Anëtar
3. Blerim	Rrema	Anëtar
4. Eralba	Mirashaj	Anëtar
5. Erido	Ndoka	Anëtar
6. Bardhok	Bardhi	Anëtar
7. Bardhok	Kovaçi	Anëtar

2 Grupi i punës, ngarkohet për realizimin e punimeve të terrenit, realizimin e punimeve të zyrës dhe hartat e ekonomisë pyjore, sipas manualit të Ministrisë së Mjedisit.
3 Ngarkohen anëtarët e grupi të punës për zbatimin e këtij urdhëri.
4 Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Pjerin NDREU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

RAPORTI I
PLANIT TË MBARËSHTIMIT
EKONOMIA PYJORE "BRINJAT E KRESHTËS"
Periudha e vlefshmërisë: 2026-2035

Hartoi:
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE
DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
BASHKIA LEZHË

P/Sektori Inxh. Artan Palushi

Specialist Inxh. Eralba Mirashaj

Specialist Inxh. Ardit Molla

Specialist Inxh. Blerim Rrema

Inspektor Inxh. Erido Ndoka

DREJTORI
Paulin GJERGJI

MIRATOHET
KRYETARI
Pjerin NDREU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Viti 2026

PËRMBAJTJA E PLANIT TË MBARËSHTIMIT

1. HYRJE
1.1 Qëllimi dhe objektivat e planit të mbarështimit të pyjeve dhe Kullotave, (PMPK)
1.2 Ecuria e punës dhe përgjegjësitë
1.3 Metodologjia e punës
1.4 Informacioni i përdorur në hartimin e PMPK
2 PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË PYJORE
2.1 Informacion i përgjithshëm rreth Ekonomisë Pyjore
2.2 Pronësia, administrimi, organizimi
2.3 Vendndodhja gjeografike dhe ndarja administrative
2.4 Konteksti i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore
2.5 Historiku i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave në Ekonominë Pyjore
2.6 Situata demografike dhe social ekonomike
2.7 Marketingu i produkteve pyjore drusore dhe jo drusore
2.8 Gjuetia dhe peshkimi
2.9 Prania e zonave të mbrojtura, specieve dhe stacioneve
3 GJENDJA AKTUALE E PYJEVE DHE KULLOTAVE
3.1 MBARËSHTIMI DHE FUNKSIONET E PYJEVE E KULLOTAVE
3.1.1 Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)
3.1.2 Forma e qeverisjes (aktuale dhe propozimet)
3.1.3 Ndarja e ekonomisë pyjore në parcela dhe nënparcela
4 KUSHTET STACIONALE
4.1 Klima
4.2 Topografia dhe morfologjia
4.3 Gjeologjia
4.4 Tokat
4.5 Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë
4.6 Erozioni në shpate dhe rrjedhjet ujore
4.7 Rrëshqitjet
5 VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI
5.1 Brezat bioklimatike
5.2 Pyjet dhe kullotat

5.3 Tipet e pyjeve
5.4 Tipet e kullotave
5.5 Tipet potenciale te vegjetacionit
5.6 Biodiversiteti
5.7 Prania e vlerave konservuese të larta (VKL)
5.8 Rreziqet për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin
5.9 Mundësitë për aktivitetet didaktike dhe kërkime shkencore
6 ANALIZA E PYJEVE DHE KULLOTAVE
6.1 ANALIZA E TË DHËNAVE PËR PYJET
6.1.1 Analiza e tipeve të pyjeve
6.1.2 Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas formës së qeverisjes
6.1.3 Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimit
6.2 ANALIZA E TË DHËNAVE TË KULLOTAVE
6.2.1 Gjëndja e kullotave
7 REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE
7.1.2 Volumi dhe rritja në volum e grumbujve pyjor
7.1.3 Struktura Vertikale
7.1.4 Cilësia e materialit drusor
7.1.5 Biomasa dhe Faktorët e Ekspansionit të Biomasës
7.1.6 Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e karbonit
7.2 Gjëndja shëndetsore dhe fitosanitare
7.2.1 Drurët e tharë
7.2.2 Dëmtimet e tjera
7.3 Prerjet e paligjshme
7.3.1 Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet në proçesin e planifikimit
7.3.2 Impakti i prerjeve ilegale në planifikimin dhe mbarështimin e pyjeve
7.4 Rezultatet e Inventarizimit te Kullotave
7.4.1 Tipi dhe cilësia e kullotave
7.4.2 Përdoruesit e kullotave dhe koha
7.4.3 Llojet e bagëtive
7.4.4 Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kullotave
7.4.5 Infrastruktura aktuale

8 OBJEKTIVAT E MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

8.1 Objektivat e përgjithshme për planifikimin afatgjatë

8.2 Objektivat kombëtare për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave, Pajtueshmëria e PMPK me planifikimin rajonal dhe atë në nivel Bashkie

8.3 Objektivat kryesore të PMPK

8.4 OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË EKONOMISË PYJORE/NJM

8.4.1 Objektivat specifikë mbi përdorimin e tokës, funksionin dhe formën e qeverisjes

8.4.2 Objektivat specifikë mbi tipet e pyjeve

8.4.3 Objektivat specifikë silvikultural

8.4.4 Objektivat specifik për kullotat

8.4.5 Objektivat specifikë mbi biodiversitetin

8.4.6 Objektivat specifikë mbi gjëndjen shëndetsore

8.4.7 Objektivat specifikë mbi faunën

8.4.8 Objektivat specifikë për pyjet me funksion prodhues

8.4.9 Objektivat specifikë për pyjet me funksion mbrojtës

8.4.10 Objektivat specifikë për pyjet me funksion rekreacioni

8.4.11 Objektivat specifik për pyjet me funksion konservues

9 MASAT/AKTIVITETET E PLANIFIKUARA NË KUADËR TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

9.1 Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit

9.2 Prerja vjetore silvikulturore

9.3 Planifikimi vjetor i masave

9.3.1 Masat në Pyje

9.3.2 Masat në kullota

9.3.3 Masat në infrastrukturë dhe në zonat e degraduara, rekreacionale dhe didaktike

9.4 Masat afat-gjata

9.4.1 Masat silvikulturale në trungishte

9.4.2 Masat silvikulturore në shkurre

9.4.3 Pyllëzimi, ripyllëzimi

9.4.4 Gjëndja dhe masat në infrastrukturën e ekonomisë pyjore

9.4.5 Masat specifike për aktivitetet rekreacionale dhe didaktike

10 PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I ZJARREVE NË PEIZAZH

111 VLERËSIMI EKONOMIK

122 LIDHJA MIDIS PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE E KULLOTAVE DHE ALFIS

133 MONITORIMI I ZBATIMIT TË PMPK

144 PËRGATITJA E HARTAVE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani i Mbarështimit të Ekonomisë pyjore Brinjat e Kreshtës, synon që të merren në konsideratë të gjithë faktorët që lidhen direkt ose indirekt ndërmjet tyre – popullata lokale, administrimi i pyjeve dhe kullotave, ekoturizmi, interesi që ofron pylli, blegtorët etj, pa harruar kufizimin e erozionit, ruajtjen e natyrës dhe stabilitetin e resurseve, plotësimin e nevojave me material drusor, bazë ushqimore për blegtorinë, si dhe përdorimi i prodhimeve të dyta pyjore nëpërmjet një zhvillimi të qëndrueshëm të pyjeve. Mbrojtja e ekosistemeve natyrore, përmirësimi i peisazhit rural dhe mbrojtja e biodiversitetit përbën një drejtim të rëndësishëm të projektit dhe zgjerimi i këtyre zonave do të jetë në qëndër të objektivave të veçantë.

Gjithashtu vend të veçantë zë përfshirja e interesave të komunitetit dhe të pjesëmarrësve të tjerë veprues në territorin e kësaj ekonomie, harmonizimi i këtyre interesave në përputhje me mundësinë aktuale dhe potenciale të pyllit.

Ekonomia Pyjore Brinjat e Kreshtës ndodhet brënda kufijve të Njësisë Administrative Ungrej e cila ka një popullsi prej 2488 banorë, me 878 familje e rreth 750 krahë pune.

Fondi pyjor i ekonomisë të marrë në studim është 4618.14 ha, nga e cila 3274.83 ha janë sipërfaqe pyjore, këtu përfshihen edhe shkurret.

Në pjesën tjetër përfshihen; sipërfaqe kullotë 437.8 ha dhe sipërfaqe jo prodhuese 905.51 ha.

Trungishtet janë gjithsej 609.86 ha me volum 7608.6 m^3, cungishtet janë 2038.5 ha me volum 35235.4 m^3, shkurre 626.47 ha me volum 3854.35 m^3.

Volumi i përgjithshëm i masës drunore është rreth 48251.6 m^3. Drutë e zjarrit për nevojat e banorëve të Nj.Ad. Ungrej sigurohen pjesësisht nga pyjet e ekonomisë Brinjat e Kreshtës.

Pyjet e ekonomisë janë natyrore, përjashtuar pyjet trungishte me pishë të zezë që zënë një sipërfaqe prej rreth 705.2 ha që janë pyje artificialë dhe në këtë plan mbarështrimi janë propozuar të jenë me funksion prodhues, pjesa tjetër dhe shkurret po ashtu me funksion prodhues.

Duke harmonizuar mendimin e komunitetit me atë teknik në projekt janë propozuar punime të ndryshme si përmirësime pyjore në llojin lis, duke zbatuar rigorozisht kriteret teknike të trajtimit silvikultoror që krahas vjeljes së materialit drusor me rreth 9434 m^3. Punime të tjera janë parashikuar; krasitje në pyll pishe, përmirësim kullote dhe ndërtim Lerash.

Detyrat kryesore për 10 vjeçarin e ardhshëm në zbatim të këtij Plani Mbarështimi rrjedhin nga programi strategjik i Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e sektorit pyjor në harmoni të plotë me programet e Bashkisë Lezhë dhe Njësinë Administrative Ungrej.

Harta e vendndodhjes së ekonomisë Pyjore "BRINJAT E KRESHTËS"

NJËSIA ADMINISTRATIVE UNGREJ

EP BRINJAT E KRESHTËS



1. HYRJE

1.1.Qëllimi dhe objektivat e planit të mbarështimit të pyjeve dhe Kullotave, (PMPK)

Ekonomia pyjore "Brinjat e Kreshtës", është inventarizuar për herë të fundit në vitin 1982, para 44 viteve bazuar në manualin përkatës, nën drejtimin e ish Institutit të Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave.

Gjatë kësaj periudhe e cila përfshin edhe tranzicionin që po kalon shoqëria jonë, rrjedhimisht edhe pyjet dhe kjo ekonomi pyjore ka pësuar ndryshime të ndjeshme dhe mjaft të mëdha, si përsa i përket strukturës, ashtu dhe shpërndarjes së vëllimit, sipas klasave të moshës dhe prodhimit, si rrjedhojë e aktivitetit njerëzor.

Nisur nga fakti që plani aktual i inventarizimit është shumë i vjetër dhe nuk pasqyron realitetin, ishte e domosdoshme hartimi i një plani të ri të mbarështimit, i cili pasqyron gjëndjen reale të grumbujve pyjorë të kësaj ekonomie.

Në objektivat e këtij plani mbarështimi një vënd të rëndësishëm zë qëllimi primar "sigurimi i një mbarështimi të qëndrueshëm dhe shumë funksional i pyllit".

Qëllimi kryesor i hartimit të planit të mbarështimit është rishikimi dhe hartimi i një plani që të plotësojë objektivat afat-shkurtra dhe afat-gjata në përputhje me tipet e grumbujve pyjor. Janë prezantuar tek të gjithë aktorët objektivat e projektit të ri, duke e organizuar punën për administrimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore Brinjat e Kreshtës.

Bazë për ecurinë e punës është korniza ligjore ekzistuese.

Është bërë rivlerësimi i parcelave dhe n/parcelave, sipas programit Acces, dhe janë nxjerrë të gjitha rezultatet, duke përcaktuar edhe masat e punimeve përmirësuese.

1.2. Ecuria e punës dhe përgjegjësitë

Fillimisht është kryer puna përgatitore për sigurimin e bazës materiale, si instrumentet e ndryshëm, dokumentacionin e nevojshëm, planin e inventarizimit aktual, hartat topografike e parcelare, përgatitjen e formularëve për punimet e terrenit etj.

Faza tjetër lidhet me punimet e terrenit, për ndërtimin e rrjetit të sipërfaqeve provë dhe marrjen e të dhënave të nevojshme. Pas përfundimit të punimeve të terrenit, u bë përpunimi i të dhënave me program kompjuterik, u përgatitën hartat dixhitale të gjendjes dhe të punimeve, si dhe hartimi i raportit të planit të mbarështimit. Që në fazën e punës përgatitore si dhe gjatë kohës së punimeve të terrenit dhe përgatitjes së planit të mbarështimit, ka patur një bashkëpunim të vazhdueshëm me specialistët e **Sektorit të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave Bashkia Lezhë**, të cilët kanë ndihmuar në ecurinë dhe përcaktimin e objektivave të planit të mbarështrimit.

1.3.Metodologjia e punës

Punimet e terrenit dhe ato të zyrës janë kryer në bazë të kërkesave të udhëzuesit përkatës. Kufinjtë e vjetër brenda ekonomisë janë ruajtur për ndarjen e parcelave, ndërsa në ndarjen e n/parcelave ndryshimet kanë ardhur si rrjedhojë e gjëndjes aktuale të çdo parcele. Por nga ana tjeter, janë pasqyruar kufinjtë real të secilës parcelë, në funksion të shtrirjes aktuale të vegjetacionit.

Inventarizimi me sipërfaqe provë është bërë duke zbatuar kriteret e përcaktuara. Madhësia e sipërfaqeve provë varion nga 25 m^2 në pyjet shkurre dhe në pyjet e lartë për drurët me diametër nga 6 cm në 9 cm, 200 m^2 në pyjet cungishte me moshë më të vogël se 30 vjeç dhe në trungishtet 400 m^2 në grumbujt pyjorë mbi 40 vjeç.

1.4. Informacioni i përdorur në hartimin e PMPK

Si bazë për hartimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore "Brinjat e Kreshtës", kanë shërbyer dokumentacioni ekzistues, i disponuar nga **Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave**.

Materialet bazë të përdorura për hartimin e planit të mbarështimit kanë qënë:

- plani i vjetër i ekonomisë,
- hartat e ekonomisë, me ndarjet në parcela e n/ parcela, të gjendjes dhe të punimeve
- hartat topografike në shkallë 1:25000,
- ortofoto (imazhe) satelitore,
- pasqyrat dendrometrike për llojet kryesore pyjore,
  informacione të ndryshme të sektorit pyjor.

2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË PYJORE

2.1.Informacion i përgjithshëm rreth Ekonomisë Pyjore

Ekonomia Pyjore ***Brinjat e Kreshtës***, bën pjesë në bazenin Ujëmbledhës të Lumit Gjadër të Bashkisë Lezhë.

Bashkia e Lezhës, përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh me status të vecantë. Në Bashkinë e Lezhës, funksionojnë gjithsej 9 Njësi Administrive rurale. Njësitë Administrative gëzojnë statusin e përcaktuar me Ligj.

Plani i mbarështimit të Ekonomisë Pyjore Brinjat e Kreshtës, me periudhë vlefshmërie 2026 deri 2035, bëhet për herë të parë, pas Planit të Inventarizimit të Ekonomisë Pyjore Brinjat e Kreshtës i vitit 1982. Sipas Planit të Inventarizimit të Ekonomisë Pyjore Brinjat e Kreshtës viti 1982, Sipërfaqja e Përgjithshme e Ekonomisë Pyjore ishte 4618.14 ha, nga e cila: Sipërfaqe Pyjore gjithsej 3274.83 ha, Sipërfaqe Kullosore 437.8 ha si dhe Sipërfaqe të zhveshura 905.51 ha.

Gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur ndryshime në sipërfaqe pyjore, shtesa e pakësime të sipërfaqeve sipas mënyrës së qeverisjes së tokës, të cilat janë evidentuar në projektin e ri, referuar "Manuali i planeve të mbarështimit te pyjeve dhe kullotave", janar 2019. Sipërfaqja Totale e Ekonomisë Pyjore Brinjat e Kreshtës rezultoi 4547.11 ha. Për këto arsye, ishte urgjente hartimi i këtij Plani të ri Mbarështimi, me synim menaxhimin e qendrueshëm, qeverisjen dhe trajtimin e pyjeve, dhe plotësimin e të gjithë funksioneve të tyre.

Qëllimi kryesor i hartimit të planit të mbarështimit është rishikimi dhe hartimi i një plani që të plotësojë objektivat afat-shkurtra dhe afat-gjata në përputhje me tipet e grumbujve pyjore. Janë prezantuar tek të gjithë aktorët objektivat e projektit të ri, duke e organizuar punën për administrimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore Brinjat e Kreshtës. Bazë për ecurinë e punës është korniza ligjore ekzistuese.

Është bërë rivlerësimi i parcelave dhe n/parcelave, sipas programit access, dhe janë nxjerrë të gjitha rezultatet, duke përcaktuar edhe masat e punimeve përmirësuese.

2.2. Pronësia, administrimi, organizimi

Bazuar në të dhënat mbi pyjet e kullotat e zonës, rezulton se para vitit 1945 fondi pyjor dhe kullosor ka qenë i ndarë sipas fshatrave me kufij të qartë midis tyre. Fshati i ka patur të ndarë pyjet dhe kullotat mbi bazë fisi apo familje. Kujdesi për pyjet e fshatit ka qenë i mirë, prandaj grumbujt pyjorë ishin në gjendje zhvillimi të kënaqshëm.
Pyjet shfrytëzoheshin nga komuniteti duke respektuar disa regulla teknike të vendosura bashkërisht. Kjo edhe për kullotat. Kush prishte këto rregulla gjobitej nga kryepleqësia e fshatit. Pas vitit 1945 u bë shtetëzimi i pyjeve dhe kullotave si kudo në vendin tonë. Kjo ndikoi në një farë mase edhe në dëmtimin e ekonomisë pyjore.
Pas vitit 1960 të drejtën e përdorimit ligjor e kishte vetëm shteti. Fshatarët i siguronin drutë dhe lendën sipas planit. Shfrytëzimet e pyjeve bëheshin nga ndërmarrjet shtetërore dhe pas vitit 1990 nga firmat private të licensuara. Por prerjet e paligjshme kanë dëmtuar shumë sipërfaqet pyjore sidomos në shkurre dhe dushqe. Një konstatim kuptimplotë është edhe fakti se në disa pjesë ngastrash në afërsi të shtëpive të banimit pyjet janë ruajtur, përvojë e cila duhet përkrahur dhe përgjithësuar nga të gjitha pjesët e Ekonomisë.
Ka ekzistuar dhe në të kaluarën, por edhe sot pjesëmarrja e gruas në punimet në pyje dhe në vjeljen e prodhimeve pyjore si bimët mjekësore eterovajore (bmet), frutat e pyllit etj.

2.3. Vendndodhja gjeografike dhe ndarja administrative

Ekonomia Pyjore Brinjat e Kreshtës, ndodhet në Qarkun e Lezhës, me pozicion gjeografik, anën veriore te saj, ndërmjet gjerësisë gjeografike X_1 = 19°47'40" (UTM 40008321), (Gauss Kruger 4400173.96) dhe Gjatësisë gjeografike Y_1 = 41°57'25" (UTM 4645692.96), (Gauss Kruger 4647683.75) kufizohet:

- Nga Veriu, Ekonomia Pyjore Gomsiqe, Bashkia Pukë.
- Nga Lindja me Ekonominë Pyjore Brinjat e Tërtonit dhe Bashkia Pukë
- Nga Jugu dhe Jug – Lindja: Ekonomia Pyjore Brinjat e Tërtonit, Bashkia Lezhë.
- Nga Perëndimi Ekonomia Pyjore Zadrimë, Bashkia Lezhë dhe Bashkia Vau-Dejës

Sipërfaqja e ekonomisë pyjore sipas mbarështimit të tanishëm është 4547.11 ha, nga e cila 3171.5 ha janë sipërfaqe pyjore (Tungishte, Cungishte, Shkurre, 437.8 ha kullotë, 86.8 ha sipërfaqe me bimësi pyjore 851.0 ha joprodhuese. Të gjitha kategoritë e sipërfaqeve janë të inkuadruara në përshkrim me 137 parcela. Sipas përdorimit të terrenit kategoritë shprehen në grafikun nr.2.3.1;



grafiku 2.3.1

Sipërfaqja totale e ekonomisë pyjore sipas inventarizimit të vitit 1982 ka qënë 4618.14 ha, nga e cila 3274.83 ha janë sipërfaqe pyjore (Tungishte, Cungishte, Shkurre, 437.8 ha Kullotë dhe 905.51ha Inproduktive sikurse paraqiten në grafikun e mëposhtëm (grafiku nr.2.3.2);



Grafiku 2.3.2

Ndryshimet në sipërfaqe janë pasojë e veprimtarisë së njeriut mbi pyjet dhe fondin pyjor në përgjithësi, kështu shtimi i sipërfaqes së pyjeve me mbjellje artificiale me pishë të zëzë dhe shtimi natyral i sipërfaqes së shkurreve dhe veçanërisht ulja e presionit mbi pyllin ka bërë që edhe volumi i materialit drusor të shtohet ndjeshëm.

Ka përmirësim të kushteve mjedisore, dhe tendencë në rritje të zhvillimit të agroturizmit, si dhe atij historik e kulturor.

2.4. Konteksti i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore

Në territorin e Bashkisë Lezhë, Pyjet dhe kullotat, menaxhohen respektivisht në 6 Ekonomi Pyjore dhe Kullosore, për të cilat, janë duke u hartuar Planet e Mbarështimit. Në afërsi të Ekonomisë Pyjore Brinjat e Kreshtës ndodhen Ekonomitë Pyjore: Brinjat e Tërtonit dhe Zadrimë.
Sipas pozicionit Gjeografik të Ekonomisë në studim, brenda sipërfaqes totale ndodhen gjthsej 5 fshatra: Kalivaç, Gjobardhaj, Zimaj, Rrasi i Butë dhe Kashnjet.
Plani i Mbarështimit, përpunimi i të dhënave të marra në terren jep një tablo të qartë të gjëndjes dhe konsistencës së pyjeve përmes spërfaqes, tipit të grumbujve pyjorë dhe të përdorimit të territorit. Grupet e punës gjatë gjithë kohës ishin në kontakt me komunitetin që banon dhe kryen veprimtarinë e tij lidhur me pyllin dhe mjedisin pyjor, duke i përfshirë në problematikat dhe trajtimin e tyre në planifikim.

2.5. Historiku i Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave në Ekonominë Pyjore

Bazuar në inventarizimin e vitit 1982 Ekonomia Pyjore dhe Kullosore Brinjat e Kreshtës ka patur këto të dhëna:

Sipërfaqja totale e ekonomisë pyjore ka qenë 4618.14 ha, e ndarë si më poshtë vijon:

Sipërfaqe pyjore gjithsej 3274.83 ha, nga kjo;

Trungishte	609.86 ha, të cilat konsideroheshin pyje prodhues,
Cungishte	2038.5 ha, të cilat konsideroheshin pyje prodhues,
Shkurre	626.47 ha, të cilat konsideroheshin pyje prodhues,

Sipërfaqe jo pyjore gjithsej 1343.31 ha, nga e cila;

- Kullota livadhe 437.8 ha,
- Sipërfaqe jo prodhuese 905.51 ha.

Sipas planit të inventarizimit të këtij viti sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor paraqitet si më poshtë vijon:
Sipërfaqja totale e ekonomisë pyjore është 4547.1 ha, e ndarë si më poshtë vijon:

Sipërfaqe pyjore aktuale është gjithsej 3171.5 ha, ose 69.75% të sipërfaqes totale, nga kjo;

Trungishte me sipërfaqe 705.2 ha, ose 15.51 % e sipërfaqes totale, propozohen të jenë trungishte me funksion prodhues.

Cungishte me sipërfaqe 1886.0 ha, ose 41.48 % sipërfaqes totale, propozohen të jenë pyje prodhues.

Shkurre me sipërfaqe 580.4 ha, ose 12.76 % e sipërfaqes totale dhe propozohen të jenë shkurre me fuksion prodhues.

Sipërfaqe jo pyjore gjithsej 1375.6 ha, ose 30.25 % e sipërfaqes totale nga e cila

- Sipërfaqe joprodhuese 851.0 ha, ose 18.72 % e sipërfaqes
- Kullota, livadhe 437.8 ha, ose 9.63 % e sipërfaqes
- Sipërfaqe me bimësi pyjore 86.8 ha, ose 1.91 % e sipërfaqes

Duhet të theksojmë se ndryshimet e sipërfaqes pyjore me shtim të saj janë rezultat i uljes së presionit mbi të si pasojë e zhvendosjes së popullsisë drejt zonave urbane jo vetëm sa i përket banimit por edhe punësimit në këto zona.

Referuar pasqyrës së mësipërme kemi shtesë të sipërfaqes në trungishte, për shkak të ripërtëritjes natyrore me pishë të zezë, shtesë të sipërfaqes në shkurre, për shkak të pakësimit të ndjeshëm të blegtorisë, dhe për pasojë veshjen e disa sipërfaqeve të kategorive joprodhuese dhe sipërfaqeve me bimësi pyjore në prodhuese me shkurre.
Shtesat kanë ardhur jo vetëm si pasojë e shkaqeve sa më sipër, por edhe rritjes së saktësisë dixhitale të matjes në gjendjen aktuale.

Në inventarizimin e vitit 1982 funksioni i pyjeve ka qënë prodhues, ndërsa me mbarështimin e ri kemi përcaktimin si në tabelën nr.**3** dhe **4** bashkangjitur Raportit.

2.6. Situata demografike dhe social ekonomike

Në Ekonominë Pyjore Brinjat e Kreshtës bëjnë pjesë gjthsej 5 fshatra, pjesë e Nj.Ad. Ungrej.
Në këto fshatra banojnë rreth 376 banorë si më poshtë vijon, (*shih tabelën nr. 2.6.1.*)

TË DHËNA DEMOGRAFIKE

tabela nr.2.6.1.

Nr	Fshati	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Krahë pune	Tokë buke (ha)	Tokë për familje (ha)	Tokë për banorë (ha)
1	Kalivaç	120	50	70	60	15	0.5	0.125
2	Kashnjet	88	40	48	42	11	0.3	0.075
3	Gjobardhaj	66	30	36	33	4.13	0.25	0.0625
4	Zimaj	56	24	32	22	2.8	0.2	0.05
5	Rras i Butë	46	20	26	18	2.07	0.18	0.045

Duke krahasuar numrin aktual të popullsisë me atë të para disa viteve do të konstatohet se ka një rënie, prej rreth 19%. Ky pakësim i banorëve të fshatit, përveç arsyeve të tjera ka ndodhur edhe veçanërisht në fshatrat e thella kodrinore etj.
Punësimi në sektorin shtetëror dhe në atë privat është i pakët. Ka mjaft forca pune në emigracion . Punonjësit e tjerë të aftë për punë merren me aktivitete bujqësorë e blegtorale, pranë minifermave të tyre.
Ne rang Njësie i takon çdo banori rreth 0,09 ha tokë bujqësore, ndërsa çdo familje 0.36 ha.
Blegtoria dhe sigurimi i bazës ushqimore.
Në këtë Njësi mbarështohen rreth 220 dhen, 920 dhi, 58 lopë dhe 44 njëthundrakë. Numri i dhive shënon një rënie në krahasim me disa vjet më parë, tregues ky pozitiv për ringritjen e pyjeve të lisit, shih tabelën nr. 3.6.3;

tabela nr. 3.6.3.

Nr.	Fshati	Lloji i blegtorisë (krerë)				Prodhimi (ton)	
		Dhen	Dhi	Gjedh	Nje thundrakë	Qumësht	Mish
1	Kalivaç	64	550	22	12	64.8	3.6
2	Kashnjet	52	-	12	9	48.6	2.7
3	Gjobardhaj	38	100	8	7	37.8	2.1
4	Zimaj	43	270	7	7	37.8	2.1
5	Rras i Butë	23	-	9	9	48.6	2.7

Sektori i blegtorisë zë një peshë të rëndësishme në ekonominë e zonës. Tendenca është që në të ardhmen numri i dhive të vijë duke u pakësuar sepse dëmton pyllin dhe nuk ka të ardhme të kënaqshme.
Baza ushqimore e bagëtive sigurohet nga mbjellja e foragjereve dhe bari i grumbulluar nga livadhet të cilat janë të pakta.

2.7. Marketingu i produkteve pyjore drusore dhe jo drusore

Historikisht brenda Ekonomisë Pyjore Brinjat e Kreshtës, janë prodhuar dru zjarri, degë voze, por edhe lëndë ndërtimi e rrumbullakët. Gjithashtu janë prodhuar sasira të mëdha qymyr druri, eshkë kovaçi, prodhim që vazhdon edhe sot në pjesë të veçanta të Ekonomisë Pyjore. Komuniteti i zonës ka grumbulluar edhe bimë mjekësore e tanifere. Prodhimet nga pylli, sidomos dru zjarri e lëndë ndërtimi, janë realizuar nga subjekte të liçensuar, dhe janë grumbulluar e magazinuar në sheshe depozitimi. Nuk ka pasur kantiere, sektorë etj. Niveli i kualifikimit të personelit ka qenë i mirë, po ashtu edhe mekanizimi i punimeve në pyje.
Sipërfaqja dhe vëllimi i pyjeve jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm;

	Viti 1982	**Viti 2026**
• Pyje gjithsej	3274.83 ha;	3171.5 ha,
• Volumi i përgjithshëm	48251.6 m^3,	78036.1 m^3,
• Lëndë punimi	8299.42 m^3,	36679.6 m^3
• Dru zjarri	39952.18 m^3.	41356.5 m^3





Shtimi i sipërfaqes së trungishteve me mbjellje artificiale me pishë të zezë dhe shtimi natyral i sipërfaqes së shkurreve dhe veçanërisht ulja e presionit mbi pyllin ka bërë që edhe volumi i materialit drusor të shtohet ndjeshëm.
Të dhëna më të hollësishme jepen në tabelat përmbledhëse të dala nga përpunimi i të dhënave të terrenit.

2.8. Gjuetia dhe peshkimi

Në ekonominë pyjore Brinjat e Kreshtës gjenden lloje të ndryshme kafshësh dhe shpendësh të egra siç mund të përmendim dhelprën, lepurin e egër, ujkun, etj. Ndër shpendët përmendim thëllëzën, turtullin, pëllumbin, qyqen, mëllenjën etj.
Gjahu i egër është gjuajtur duke mos respektuar kalendarin e gjuetisë dhe rregullat përkatëse. Gjithashtu, presioni i njeriut mbi pyllin, ka ndikuar në pakësimin gradual të faunës së egër dhe deri në zhdukjen e disa llojeve.
Meqenëse gjuetia është një e ardhur e mirë për ekonominë e fshatit, duhet të merren masa që të organizohet mirë puna për mbarështimin e saj.
Ligji aktual i Moratoriumit të Gjuetisë ka sjellë ndikim në mbrojtjen e faunës së zonës. Nuk ka të dhëna mbi kadastrën e gjuetisë bazuar në studime e azhornime.

2.9.Prania e zonave të mbrojtura, specieve dhe stacioneve

Gjatë punimeve të terrenit, vrojtimeve të kryera, por edhe nga informacionet e studimeve dhe verifikimeve, vihet re një prezencë e dushkajave të përbëra nga llojet kryesore Shpardh dhe Qarr dhe në formacionet e trungishteve Pishe e Zezë dhe Gështenjë.
Tendenca e punimeve me përmirësime do të jetë në drejtim të shtimit të pyjeve të lisit (Bulgër, Shparth, Qarr) dhe përmirësimi i pyjeve të përbëra me Pishë të Zezë dhe Gështenjë etj, lloje këto vendase, që i përkasin vegjetacionit potencial të ekonomisë.

3. GJENDJA AKTUALE E PYJEVE DHE KULLOTAVE

3.1. MBARËSHTIMI DHE FUNKSIONET E PYJEVE E KULLOTAVE

3.1.1. Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)

Bazuar në të dhënat e inventarit të vitit 1982 ndarja e grumbujve pyjorë sipas formës së qeverimit ka qënë si vijon:

- Pyje gjithsej sipas formës së qeverimit ishin 3665.94 ha, nga të cilët;
  - Trungishte 609.86 ha
  - Cungishte 2038.5 ha
  - Shkurre 626.47 ha,
- Pyje gjithsej sipas funksionit ishin 3274.83 ha, nga të cilët;
  - Pyje prodhues 3274.83 ha
  - Pyje mbrojtës -
- Pyje gjithsej sipas origjinës ishin 3665.94 ha, nga të cilët;
  - Pyje natyrore 2664.97 ha,
  - Pyje artificiale 609.86 ha.

Sipas planit të ri të mbarështrimit ndarja e grumbujve pyjorë simbas formës së qeverimit është dhe propozohet të jetë si vijon:

- Pyje gjithsej sipas formës së qeverimit janë 3171.5 ha, nga të cilët;
  - Trungishte 705.2 ha
  - Cungishte 1886 ha dhe sipërfaqja me shkurre është 580.4 ha.

Propozohet që ndarja e grumbujve pyjorë sipas formës së qeverimit të jetë sipas gjëndjes aktuale.

- Pyje gjithsej sipas funksionit janë 3171.5 ha, nga të cilët;
  - Pyje prodhues 3171.5 ha
  - Pyje Mbrojtës -
- Pyje gjithsej sipas origjinës janë 3171.5 ha, nga të cilët;
  - Pyje natyrore 2466.3 ha,
  - Pyje ½ artificialë 705.2 ha dhe 580.4 ha shkurre me origjinë natyrore.

Shtesat në trungishte janë si rezultat i pyllëzimeve artificiale të bëra deri në vitet 1980-1985, ndërsa pakësimi në shkurre vjen si rezultat i rritjes së presionit mbi prerjen apo krasitjen dhe kullotjen e shkurreve në tokat e zhveshura apo me bimësi pyjore.

3.1.2. Forma e qeverisjes (aktuale dhe propozimet)

Sipas planit të inventarizimit të vitit 1982 sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor paraqitet si më poshtë vijon:

Fond pyjor 4618.14 ha, e ndarë si më poshtë vijon:

Sipërfaqe pyjore gjithsej 3274.83 ha, nga kjo;

- Trungishte 609.86 ha, të cilat konsideroheshin pyje prodhues,

- Cungishte 2038.5 ha, të cilat konsideroheshin pyje prodhues,
- Shkurre 626.47 ha, të cilat konsideroheshin pyje prodhues,

Sipërfaqe jo pyjore gjithsej 1343.69 ha, nga e cila;

- Kullota livadhe 437.18 ha,
- Sipërfaqe jo prodhuese 905.51 ha.

Sipas planit të inventarizimit të këtij viti sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor paraqitet si më poshtë vijon:

Sipërfaqja e përgjithshme e ekonomisë pyjore Brinjat e Kreshtës është 4547.11 ha, e ndarë si më poshtë vijon:

Sipërfaqe pyjore gjithsej 3171.5 ha, nga kjo;

- Trungishte 705.2 ha, propozohen të jenë trungishte me funksion prodhues,
- Cungishte 1886.0 ha, pyje prodhues dhe Shkurre janë 580.4 ha prodhuese

Sipërfaqe jo pyjore gjithsej 1375.6 ha, nga e cila

- Sipërfaqe joprodhuese 851 ha,
- Kullota livadhe 437.8 ha,
- Sipërfaqe me bimësi pyjore 86.8 ha

Duhet të theksojmë se ndryshimet e sipërfaqes pyjore me pakësim nga Cungishte në Shkurre janë rezultat i rritjes së presionit mbi të si pasojë e mbikullotjes dhe prerjeve të paligjshme.

Regjimi i qeverisjes së pyjeve në EP	Plani i mëparshëm Inventarizimit 1982		PMPK aktual	
	Sipërfaqja (ha)	%	Sipërfaqja (ha)	%
Trungishte	609.86	18.6	705.2	22.2
Cungishte	2038.5	62.2	1886.0	59.5
Shkurre	626.47	19.2	580.4	18.3
Kullota ,livadhe	437.8	0	437.8	0
Gjithsej	**3712.63**	**100**	**3609.4**	**100.0**

Nga analiza vihet re se, kemi pakësim të sipërfaqes në formën e përdorimit "Pyje" me rreth 103 ha.

Referuar pasqyrës së mësipërme kemi shtesë të sipërfaqes në trungishte, për shkak të vijimit të ripërtëritjes natyrore me pishë zezë, pakësim të sipërfaqes në cungishte dhe pakësim të sipërfaqes në shkurre, për shkak të aktivitetit të njeriut, dhe për pasojë instalimin e vegjetacionit në disa sipërfaqeve të kategorive joprodhuese dhe sipërfaqeve me bimësi pyjore.

Pakësimet kanë ardhur jo vetëm si pasojë e shkaqeve sa më sipër, por edhe rritjes së saktësisë dixhitale të matjes në gjendjen aktuale.

Të dhëna më të hollësishme jepen në tablën nr. **3** të rezultateve të dala nga përpunimi i të dhënave sipas programit access.

3.1.3. Ndarja e ekonomisë pyjore në parcela dhe nënparcela

Ndarja në parcela e ekonomisë pyjore është bëre duke mbajtur parasysh ndarjen e vjetër, pra duke respektuar kufinjtë ekzistues. Gjatë punës në terren u konstatua se në një numër të caktuar parcelash, kishte ndryshime për sa i përket shtrirjes së pyllit, fakt i cili u mor në konsideratë nga punimet e rilevimit të terrenit. Për këtë arsye parcelave të caktuara u ka ndyshuar sipërfaqja dhe disa parcela i kanë kaluar Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore Pukë dhe kjo është një ndër të tjera arsye të zvogëlimit të sipërfaqes së ekonomisë pyjore.

Për sa u përket ndarjeve të n/parcelave, në shumicën e rasteve nuk janë marrë në konsideratë ndarjet ekzistuese, për arsye se ato ndarje nuk përfaqsojnë më realitetin. Për ndarjen e parcelave dhe nënparcelave është ndjekur rigorozisht udhëzuesi i PM duke e materializuar në terren, më poshtë po japim aspekte të ndarjes në terren, foto me nr.3.1.3.1. ndarja parcelare dhe materializimi në terren i tyre;

Ndarja parcelare dhe materializimi në terren *foto nr.3.1.3.1*





Në këto kushte, bazuar në gjendjen aktuale të grumbujve, është bërë ndarja e re në parcela dhe n/parcela sipas tabelës së mëposhtme.

Parcela	Kodi i parcelës n/parcelës	Vendndodhja	Sipërf ha	Pronësia	Përdorimi i tokës	Funksioni Kryesor
4	LE08 00 004	BRINJAT E KRESHTËS	181.2	Shtetërore	SHKURRE	Prodhues
5	LE08 00 005	BRINJAT E KRESHTËS	37.62	Shtetërore	SHKURRE	Prodhues
6	LE08 00 006	BRINJAT E KRESHTËS	42.72	Shtetërore	INPRODUKTIV	jo prodhuese
7	LE08 00 007	BRINJAT E KRESHTËS	31.3	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
8	LE08 00 008	BRINJAT E KRESHTËS	7.44	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
9	LE08 00 009	BRINJAT E KRESHTËS	43.72	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese

10	LE08 00 010	BRINJAT E KRESHTËS	37.4	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
11	LE08 00 011	BRINJAT E KRESHTËS	40.03	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
12a	LE08 00 012a	BRINJAT E KRESHTËS	44.14	Shtetërore	SHKURRE	Prodhues
12b	LE08 00 012b	BRINJAT E KRESHTËS	12.39	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
14a	LE08 00 014a	BRINJAT E KRESHTËS	6.77	Shtetërore	SHKURRE	Prodhues
14b	LE08 00 014b	BRINJAT E KRESHTËS	9.34	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
14c	LE08 00 014c	BRINJAT E KRESHTËS	27.35	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
15	LE08 00 015	BRINJAT E KRESHTËS	15.25	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
16a	LE08 00 016a	BRINJAT E KRESHTËS	15.22	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
16b	LE08 00 016b	BRINJAT E KRESHTËS	12.34	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
16c	LE08 00 016c	BRINJAT E KRESHTËS	24.86	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
17	LE08 00 017	BRINJAT E KRESHTËS	30.62	Shtetërore	SHKURRE	Prodhues
18a	LE08 00 018a	BRINJAT E KRESHTËS	34.13	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
18b	LE08 00 018b	BRINJAT E KRESHTËS	25.11	Shtetërore	SHKURRE	Prodhues
19a	LE08 00 019a	BRINJAT E KRESHTËS	21.71	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
19b	LE08 00 019b	BRINJAT E KRESHTËS	70.06	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
20	LE08 00 020	BRINJAT E KRESHTËS	65.83	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
21	LE08 00 021	BRINJAT E KRESHTËS	39.81	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
22a	LE08 00 022a	BRINJAT E KRESHTËS	12.11	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
22b	LE08 00 022b	BRINJAT E KRESHTËS	27.76	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
22c	LE08 00 022c	BRINJAT E KRESHTËS	16.96	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
22d	LE08 00 022d	BRINJAT E KRESHTËS	8.34	Shtetërore	KULLOTE	Prodhues
23a	LE08 00 023a	BRINJAT E KRESHTËS	14.56	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
23b	LE08 00 023b	BRINJAT E KRESHTËS	37.54	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
28a	LE08 00 028a	BRINJAT E KRESHTËS	19.72	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
28b	LE08 00 028b	BRINJAT E KRESHTËS	26.65	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues
28c	LE08 00 028c	BRINJAT E KRESHTËS	31.13	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
29a	LE08 00 029a	BRINJAT E KRESHTËS	38.89	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
29b	LE08 00 029b	BRINJAT E KRESHTËS	24.22	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
30a	LE08 00 030a	BRINJAT E KRESHTËS	12.99	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
30b	LE08 00 030b	BRINJAT E KRESHTËS	7.7	Shtetërore	KULLOTE	Prodhues
31a	LE08 00 031a	BRINJAT E KRESHTËS	29.12	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
31b	LE08 00 031b	BRINJAT E KRESHTËS	18.61	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
32a	LE08 00 032a	BRINJAT E KRESHTËS	18.19	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
32b	LE08 00 032b	BRINJAT E KRESHTËS	10.12	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
32c	LE08 00 032c	BRINJAT E KRESHTËS	15.5	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
33a	LE08 00 033a	BRINJAT E KRESHTËS	20.56	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
33b	LE08 00 033b	BRINJAT E KRESHTËS	19.93	Shtetërore	SHKURRE	Prodhues
34a	LE08 00 034a	BRINJAT E KRESHTËS	22.83	Shtetërore	SHKURRE	Prodhues
34b	LE08 00 034b	BRINJAT E KRESHTËS	6.25	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
35	LE08 00 035	BRINJAT E KRESHTËS	21.1	Shtetërore	KULLOTE	Prodhues
36a	LE08 00 036a	BRINJAT E KRESHTËS	14.72	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
36b	LE08 00 036b	BRINJAT E KRESHTËS	20.36	Shtetërore	KULLOTE	Prodhues
37a	LE08 00 037a	BRINJAT E KRESHTËS	36.83	Shtetërore	KULLOTE	Prodhues
37b	LE08 00 037b	BRINJAT E KRESHTËS	13.22	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
38	LE08 00 038	BRINJAT E KRESHTËS	45.95	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
39	LE08 00 039	BRINJAT E KRESHTËS	60.64	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues

40a	LE08 00 040a	BRINJAT E KRESHTËS	23.27	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
40b	LE08 00 040b	BRINJAT E KRESHTËS	11.65	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
40c	LE08 00 040c	BRINJAT E KRESHTËS	3.61	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
40d	LE08 00 040d	BRINJAT E KRESHTËS	1.9	Shtetërore	Sip me bimësi pyjore	Sip me bimësi pyjore
42a	LE08 00 042a	BRINJAT E KRESHTËS	52.71	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
43	LE08 00 043	BRINJAT E KRESHTËS	25.69	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
44	LE08 00 044	BRINJAT E KRESHTËS	26.59	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
45a	LE08 00 045a	BRINJAT E KRESHTËS	33.61	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues
46a	LE08 00 046a	BRINJAT E KRESHTËS	17.45	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
46b	LE08 00 046b	BRINJAT E KRESHTËS	12.34	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
47a	LE08 00 047a	BRINJAT E KRESHTËS	9.78	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
47b	LE08 00 047b	BRINJAT E KRESHTËS	59.38	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
48a	LE08 00 048a	BRINJAT E KRESHTËS	103	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
53a	LE08 00 053a	BRINJAT E KRESHTËS	42.4	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
54a	LE08 00 054a	BRINJAT E KRESHTËS	5.83	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
54b	LE08 00 054b	BRINJAT E KRESHTËS	4.82	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
55	LE08 00 055	BRINJAT E KRESHTËS	22.66	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
56a	LE08 00 056a	BRINJAT E KRESHTËS	40.1	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
56b	LE08 00 056b	BRINJAT E KRESHTËS	15.6	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
57a	LE08 00 057a	BRINJAT E KRESHTËS	9.13	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
57b	LE08 00 057b	BRINJAT E KRESHTËS	48.65	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
57c	LE08 00 057c	BRINJAT E KRESHTËS	3.27	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
58a	LE08 00 058a	BRINJAT E KRESHTËS	39.76	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
59a	LE08 00 059a	BRINJAT E KRESHTËS	4.71	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
59b	LE08 00 059b	BRINJAT E KRESHTËS	7.04	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
59c	LE08 00 059c	BRINJAT E KRESHTËS	13.69	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
59d	LE08 00 059d	BRINJAT E KRESHTËS	14.49	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
60a	LE08 00 060a	BRINJAT E KRESHTËS	33.97	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
60b	LE08 00 060b	BRINJAT E KRESHTËS	12.12	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
61a	LE08 00 061a	BRINJAT E KRESHTËS	37.46	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
62a	LE08 00 062a	BRINJAT E KRESHTËS	42.98	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
62b	LE08 00 062b	BRINJAT E KRESHTËS	4.45	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
63a	LE08 00 063a	BRINJAT E KRESHTËS	18.22	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
63b	LE08 00 063b	BRINJAT E KRESHTËS	11.92	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
64a	LE08 00 064a	BRINJAT E KRESHTËS	26.27	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
64b	LE08 00 064b	BRINJAT E KRESHTËS	4.26	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
64c	LE08 00 064c	BRINJAT E KRESHTËS	5.14	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
66a	LE08 00 066a	BRINJAT E KRESHTËS	55.24	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
66b	LE08 00 066b	BRINJAT E KRESHTËS	14.84	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
67b	LE08 00 067b	BRINJAT E KRESHTËS	6.17	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
68a	LE08 00 068a	BRINJAT E KRESHTËS	45.05	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues
68b	LE08 00 068b	BRINJAT E KRESHTËS	57.86	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
69	LE08 00 069	BRINJAT E KRESHTËS	50.42	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues
70	LE08 00 070	BRINJAT E KRESHTËS	44.68	Shtetërore	KULLOTE	Prodhues
71	LE08 00 071	BRINJAT E KRESHTËS	51.11	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
72	LE08 00 072	BRINJAT E KRESHTËS	47.66	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues
73	LE08 00 073	BRINJAT E KRESHTËS	44.57	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese

74	LE08 00 074	BRINJAT E KRESHTËS	75.38	Shtetërore	SHKURRE	Prodhues
75	LE08 00 075	BRINJAT E KRESHTËS	83.53	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
76	LE08 00 076	BRINJAT E KRESHTËS	102.17	Shtetërore	KULLOTE	Prodhues
77	LE08 00 077	BRINJAT E KRESHTËS	42.58	Shtetërore	KULLOTE	Prodhues
78	LE08 00 078	BRINJAT E KRESHTËS	128.7	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
79	LE08 00 079	BRINJAT E KRESHTËS	74.97	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
80	LE08 00 080	BRINJAT E KRESHTËS	25.73	Shtetërore	SHKURRE	Prodhues
81	LE08 00 081	BRINJAT E KRESHTËS	50.33	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
82	LE08 00 082	BRINJAT E KRESHTËS	45.56	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
83	LE08 00 083	BRINJAT E KRESHTËS	75.35	Shtetërore	KULLOTE	Prodhues
84	LE08 00 084	BRINJAT E KRESHTËS	50.65	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
85	LE08 00 085	BRINJAT E KRESHTËS	28.45	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
86	LE08 00 086	BRINJAT E KRESHTËS	43.09	Shtetërore	KULLOTE	Prodhues
87a	LE08 00 087a	BRINJAT E KRESHTËS	7.07	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
87b	LE08 00 087b	BRINJAT E KRESHTËS	2.74	Shtetërore	SHKURRE	Prodhues
87c	LE08 00 087c	BRINJAT E KRESHTËS	18.6	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
88	LE08 00 088	BRINJAT E KRESHTËS	66.6	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
90	LE08 00 090	BRINJAT E KRESHTËS	35.55	Shtetërore	KULLOTE	Prodhues
91a	LE08 00 091a	BRINJAT E KRESHTËS	69.45	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues
91b	LE08 00 091b	BRINJAT E KRESHTËS	30.74	Shtetërore	INPRODUKTIVE	jo prodhuese
92a	LE08 00 092a	BRINJAT E KRESHTËS	17.4	Shtetërore	SHKURRE	Prodhues
92b	LE08 00 092b	BRINJAT E KRESHTËS	8.04	Shtetërore	SHKURRE	Prodhues
93b	LE08 00 093b	BRINJAT E KRESHTËS	28.77	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
94	LE08 00 094	BRINJAT E KRESHTËS	44.66	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
95	LE08 00 095	BRINJAT E KRESHTËS	55.13	Shtetërore	CUNGISHTE	Prodhues
97a	LE08 00 097a	BRINJAT E KRESHTËS	24.11	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues
97b	LE08 00 097b	BRINJAT E KRESHTËS	4.33	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues
98a	LE08 00 098a	BRINJAT E KRESHTËS	76.07	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues
99a	LE08 00 099a	BRINJAT E KRESHTËS	40.03	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues
100	LE08 00 100	BRINJAT E KRESHTËS	28.19	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues
101	LE08 00 101	BRINJAT E KRESHTËS	13.33	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues
102	LE08 00 102	BRINJAT E KRESHTËS	49.21	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues
103	LE08 00 103	BRINJAT E KRESHTËS	41.93	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues
104	LE08 00 104	BRINJAT E KRESHTËS	72.82	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues
105	LE08 00 105	BRINJAT E KRESHTËS	82.87	Shtetërore	SHKURRE	Prodhues
106b	E08 00 106b	BRINJAT E KRESHTËS	84.93	Shtetërore	Sip me bimësi pyjore	Sip me bimësi pyjore
106a	LE08 00 106a	BRINJAT E KRESHTËS	21.67	Shtetërore	TRUNGISHTE	Prodhues

4. KUSHTET STACIONALE

4.1. Klima

Ekonomia Pyjore "Brinjat e Kreshtës", e vendosur në zonën e Ungrejt, Bashkia Lezhë, karakterizohet nga kushte klimatike me ndikim mesdhetar, të modifikuara nga relievi kodrinor-malor dhe lartësia mbi nivelin e detit.

Klima karakterizohet nga vera të ngrohta deri të nxehta, me periudha të thata, dhe dimra të freskët deri të ftohtë e me reshje të shumta. Pjesa më e madhe e reshjeve atmosferike bie gjatë

gjysmës së ftohtë të vitit, veçanërisht në vjeshtë dhe dimër, ndërsa gjatë verës sasia e reshjeve zvogëlohet dhe mund të krijohen periudha thatësire.
Temperatura dhe regjimi i reshjeve ndryshojnë në varësi të lartësisë, ekspozicionit dhe pjerrësisë së terrenit. Këta faktorë ndikojnë në kushtet e rritjes së bimësisë pyjore, përhapjen e llojeve drunore, rigjenerimin natyror dhe produktivitetin e masiveve pyjore.
Gjatë periudhave të thata të verës, sidomos në parcelat me ekspozicion jugor dhe në terrenet me bimësi të thatë, mund të rritet rreziku i zjarreve pyjore. Nga ana tjetër, reshjet intensive në terrenet me pjerrësi të madhe mund të favorizojnë rrjedhjen sipërfaqësore të ujërave dhe proceset e erozionit të tokës.
Diellzimi. Një nga elementet bazë që karakterizon klimën e një zone është regjimi i diellzimit, i shprehur me anë të numrit të ditëve të kthjellta e të vranëta. Për zonën në studim, numri i ditëve të kthjellta luhatet nga 6÷7 dite në muajt e dimrit deri në 19÷22 ditë në muajt e verës. Mesatarisht gjatë vitit vrojtohen rreth 1÷2 dite të vranëta në periudhën e verës dhe 10÷12 ditë të tilla gjatë e dimrit.
Shifrat tregojnë një potencial të konsiderueshëm të energjisë diellore për zonën në studim, element ky shumë i favorshëm për zhvillimin ekonomik të zonës.
Temperatura e ajrit një element shumë i rëndësishëm në karakterizimin e klimës së një zone të caktuar është regjimi i temperaturave.
Temperatura mesatare vjetore luhatet nga 10.5 deri 19.7 C. Janari është muaji më i ftohtë i vitit. Ai karakterizohet nga luhatje të temperaturës 2.2 ÷ 4.2 C. Gjatë muajit më të ngrohtë, korrikut, temperatura mesatare luhatet nga 32 ÷ 34 C.
Reshjet
Reshjet në hapsirën e Lezhës arrijnë në 1200 mm në vit. Këto vlera janë relativisht jo të larta krahasuar me mesataren vjetore në rang vendi që është rreth 1450 mm. Sasia më e madhe e reshjeve bie gjatë periudhës së ftohtë të vitit, duke arritur kulmin në muajin nëntor me 172.9 mm, ndërsa muaji më i thatë i vitit është gushti me 19.12mm.



4.2. Topografia dhe morfologjia

Në lartësinë deri 200 m shtrihen 307.98 ha pyje ose 8% e tyre, në lartësinë 200 – 400 m, shtrihen 2358.85 ha pyje ose 61.4 e sipërfaqes së tyre, midis lartësisë 401 – 600 m shtrihen 1027.43 ha ose 26.7 % e siperfaqes së tyre dhe midis lartësive 601 – 800 m shtrihen 146.65 ha pyje ose 3.8% e sipërfaqes.

Kuota më e ulët e ekonomisë pyjore është 170 m, në fushën e Papardhokut Kalivaç, kurse kuota më e lartë është 483 m, në parcelën 82 në kufirin ndarës të ekonomisë.

4.3. Gjeologjia

Gjatë përshkrimit në terren, përcaktuam edhe morfologjinë, gjeologjinë, tokën, pjerrësinë, kundrejtimin, altitudën etj, të çdo parcelave, e cila i bashkëngjitet projektit. Kështu mund të themi se territori i ekonomisë perbëhet nga fusha, kodrina të vogla deri mesatare, shpate e lugina.

Përgjithësisht është reliev i thyer kodrinor me proska të shumta të cilat paraqiten të veshura me vegjetacionin e dushqeve dhe pishës së zezë.



Foto nr.3.5.1, pamje e marrë në nënparcelën 102 me Pishë të Zezë dhe në 22a me Dushqe.

Kundrejtimi i përgjithshëm është jugor e jug-perëndimor. Ka ngastra me pjerrësi të vogël dhe mesatare, por ka edhe me pjerrësi të mëdha ku ka filluar dukuria e erozionit, aty ku pylli është dëmtuar. Këto nën parcela sidomos ato me Pishë të Zezë të krijuara artificialisht janë propozuar si pyje Prodhues.

4.4. Tokat

Në ekonominë pyjore të marrë në studim mbizotërojnë tokat e hinjta kafe dhe tokat e kafenjta. Dihet se vetitë fiziko mekanike të tokës ndikojnë në organizmat e gjalla. Nga shkëmbi amnor varet dhe toka mbi të cilën zhvillohen drurët dhe bimët. Ky ndikim është reciprok, sepse edhe vegjetacioni ndikon në natyrën e tokës.
Tokat e hinja kafe takohen në lartesitë deri në 600 m mbi nivelin e detit, ku rriten bimësi tipike për zonën mesdhetare. Në vende me toka të varfëra takohet dellënja e kuqe, frashëri i bardhë, shqemja, shqopa etj. Këto toka janë karakteristike për zonat mesdhetare para malore ku vera është e thatë pa reshje dhe dimri i butë e më shumë reshje. Tokat e hinjta kafe të shpërlara e kanë horizontin A deri ne 10 cm, me strukturë arrore të pluhurosur dhe përbërja mekanike është subargjilore e mesme. Kur këto toka janë të zhveshura dhe të pjerrta duhet të pyllëzohen me lloje që rriten dhe zhvillohen shpejt si pishat, akacia etj.

4.5. Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë

Territori i shtrirjes së ekonomisë pyjore të marrë në studim përshkohet nga shumë përrenj dhe përroska të cilët derdhen në përroin e Gjadrit. Ky përrua e ndan ekonominë në mes dhe gjatë dimrit kur ka shira të vazhdueshëm, kalohet vetëm nëpërmjet urës. Disa nga perrenjtë e tjerë që mund të përmenden janë perroi i Vomës, përroi i Kashnjetit, perroi i Kalivaçit, përroi i Rrasit etj.
Në brendësi të ekonomisë ka një rezervuar për grumbullimin e ujrave sikurse shihet në foton e mëposhtëme me nr.4.5.1.



Foto nr.4.5.1.
Respektivisht; Rezervuari i Kashnjetit.

4.6. Erozioni në shpate dhe rrjedhjet ujore

Nga vëzhgimet në terren të grupit të punës u konstatua se në shumë raste erozioni mungon dhe në ndonjë rast sporadik ka prezencë sipërfaqësore. Por sidoqoftë ky fenomen nuk duhet nënvlerësuar se edhe këtu kemi pak sipërfaqe të zhveshura, të dëmtuara deri në atë shkallë sa që janë kthyer në kullota të degraduara.

4.7. Rrëshqitjet

Rrëshqitjet si fenomen hasen vetëm përgjatë përrenjve dhe proskave me pjerrësi të madhe dhe për të cilat duhet treguar kujdes i vazhdueshëm, të mos dëmtohet dhe pritet bimësia e instaluar në shpatet përgjatë rrjedhjes së tyre.

5. VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI

5.1. Brezat bioklimatike

Brezi i shkureve dhe i pyjeve mesdhetarë.
Ky brez gjendet deri ne 700m lartësi, në trevat perëndimore dhe jugperëndimore. Pjesën më të madhe të tij e zënë shkurret me gjelbërim të perhershëm me llojet si: Shqopë, Dëllinjë e Kuqe, Krisha etj. Së bashku me këto shkurre rriten edhe disa drurë të lartë si: Shpardh, Qarr, Bulgër, Bungëbutë dhe llojet e mbjella artificialisht si Pishë e Zezë, Gështenja etj, që në disa raste formojnë pyje të konsiderueshme. Pjesën tjetër të brezit të shkurreve dhe pyjeve mesdhetare e zënë shkuret që i rrezojnë gjethet gjatë stinës së dimrit si: Frashëri i Bardhë, Shqemja etj.

5.2. Pyjet dhe kullotat

Bazuar në informacionin e përshkrimit parcelar shpërndarja e pyjeve dhe kullotave në ekonominë pyjore të marrë në studim jepet si më poshtë:

- Sipërfaqja totale e ekonomisë pyjore 4547.1 ha
- Sipërfaqja e mbuluar nga pyjet 3171.5 ha
- Sipërfaqja e mbuluar nga pyjet në % 69.45 %
- Sipërfaqja e mbuluar nga shkurret 580.4 ha
- Sipërfaqja e mbuluar nga shkurret në % 12.76 %
- Sipërfaqja e mbuluar nga kullotat 437.8 ha
- Sipërfaqja e mbuluar nga kullotat në % 9.63 %
- Sipërfaqe me bimësi pyjore 86.8 ha
- Sipërfaqe me bimësi pyjore bë % 1.91%
- Jo prodhuese 851.0 ha
- Jo prodhuese në % 18.72 %

5.3. Tipet e pyjeve

Brënda ekonomisë pyjore tipet e grumbullit aktual sipas funksioneve dhe perqindja ndaj totalit të sipërfaqes jepen në tabelën nr.5.3.1

tabela 5.3.1

Tipi i Grumbullit	Funksioni: Total ha	I %	Prodhues ha	I %	Mbrojtës ha	I %
Ekonomia pyjore : Brinjat e Kreshtës						
Pyje me Pishë të Zezë	644.9	24.9	0	0.0	0	0.0
Pyje me Gështenjë	26.7	1.0	0	0.0	0	0.0
Pyje Gështenje me dushqe	33.6	1.3	0	0.0	0	0.0
Pyje me qarr	7.1	0.3	0	0.0	0	0.0
Pyje qarri me dushqe të tjerë	115.3	4.4	0	0.0	0	0.0
Pyje shpardhi me dushqe të tjerë	1763.6	68.1	0	0.0	0	0.0
TOTALI	2591.2	100	0	0.0	0	0.0

Sipas tabelës nr.5.3.1 sipërfaqen më të madhe e zënë pyjet e dominuar nga lloji pyje Shpardhi me dushqe të tjerë.

5.4. Tipet e kullotave

Në këtë ekonomi janë 437.8 ha livadhe të cilët kulloten në periudhë vere.

5.5. Tipet potenciale te vegjetacionit

Tipet e vegjetacionit potencial sipas funksioneve/përqindja ndaj totalit të sipërfaqes pyjore sipas mbarështimit në studim jepen në tabelën e mëposhtëme me nr.5.5.1

tabela 5.5.1

Tipi i vegjetacionit	Funksioni: Total ha	I %	Prodhues ha	I %	Mbrojtes ha	I %
Ekonomia pyjore : Brinjat e Kreshtës						
Formacion pyjor Gështenje	60.26	2.0	60.26	2.0	0	0.0
Formacione pyjore të Pishës së Zezë	644.91	21.7	644.91	21.7	0	0.0
Formacion dushkajash.	1644.8	56.8	1644.8	55.3	0	0.0

Formacione shkurrore i Dushqeve	580.38	19.5	580.38	19.5	0	0.0
TOTALI I EKONOMISË	2975.9	100.0	2975.9	100.0	0	0.0

5.6. Biodiversiteti

Grumbujt e ekonomisë pyjore Brinjat e Kreshtës janë:

- Sipërfaqe me grumbuj Alteruar që i përkasin kodit (PN), 705.17 ha, me llojet kryesore të cilat janë të përshkruara më poshtë;
  - Pishë e Zezë (Pinus Nigra)

Në këtë ekonomi është e shoqëruar me shkurre të tjera në disa parcela të saj, mbrojtja dhe shtimi është detyrë e rëndësishme e ndërmarrë edhe nga komuniteti përmes zbatimit të këtij plani mbarështrimi.

- Sipërfaqe me grumbuj Alt.Moderuar që i përkasin kodit (PN), 48.65 ha, me llojet kryesore të cilat janë të përshkruara më poshtë;
  - Gështenja (Castanea Sativa)

Në këtë ekonomi është e shoqëruar me dushqe të tjera në një parcelë, mbrojtja dhe shtimi është detyrë e rëndësishme e ndërmarrë edhe nga komuniteti përmes zbatimit të këtij plani mbarështrimi.

- Sipërfaqe me grumbuj Natyral që i përkasin kodit (PN), 2384.5 ha, me llojet kryesore të cilat janë të përshkruara më poshtë;
  - Shpardhi (Quercus Fraineto)

Në këtë ekonomi është i shoqëruar me dushqe të tjerë në disa parcela të saj, mbrojtja dhe shtimi është detyrë e rëndësishme e ndërmarrë edhe nga komuniteti përms zbatimit të këtij plani mbarështrimi.

- Qarr (Quercus Cerris)

Në këtë ekonomi është i shoqëruar me dushqe të tjerë në disa parcela të saj, mbrojtja dhe shtimi është detyrë e rëndësishme e ndërmarrë edhe nga komuniteti përms zbatimit të këtij plani mbarështrimi.

- Shqopa e Butë (Erica Arborea)

Në ekonominë Brinjat e Kreshtës Shqopa e Butë rritet në trajtë shkurreje dhe si dru i vogël, depërton nëpër lugina, do shumë ngrohtësi, nga vëndasit përdoret për fshesa dhe druri i nxjerrë nga rrënjët përdoret për koka pipash shumë të larmishme.

Për sa u përket habitateve, kemi parasysh ndryshimin e tyre në varësi të llojit të shqyrtuar. Për këtë arsye habitatet i kemi grupuar në:

- Habitate pyjore dhe shkurrore

Habitatet pyjore dhe shkurrore

Këto habitate përmbledhin habitatet e pyllit të Pishës së Zëzë, Gështenjës, Shpardhit si dhe ato të Qarrit.

Reptilet

Reptilet e habitateve pyjore të Ekonomisë Pyjore "Brinjat e Kreshtës"

Nr	Emri latin	Emri shqip
▪	Testudo hermani	Breshka e zakonshme
▪	Lacerta viridis	Zhapiu i gjelbër
▪	Podarcis muralis	Hardhuca e mureve
▪	Podarcis taurica	Hardhuca e barit
▪	Elaphe longissima	Bolla e shtepisë
▪	Vipera ammodytes	Nëperka

Shpendet

Grupi i shpendëve është më i gjithëpranishëm në zonat pyjore në çfarëdo lloj periudhe të vitit.

Llojet e shpendëve të vrojtuara dhe të pritshëm në habitatet pyjore të ekonomisë pyjore "Brinjat e Kreshtës":

Nr	Emri latin	Emri shqip	Statusi	Përhapja
–	Buteo buteo	Huta	V	Gjithë territori
–	Falco peregrinus	Krahëthati	-	
–	Accipiter gentiles	Gjeraqina	V	Gjithë territorin
–	Columba palumbus	Gugashi	-	Gjithë territorin
–	Cuculus canorus	Qyqja	-	Gjithë territorin
–	Galeria cristata	Dërvishi	-	Toka të hapura
–	Sylvia cantillans	Bilbilthi gushkuq	R	Gjithë territorin
–	Alectoris graeca	Thëllënza e malit		Në zona shkëmb.
–	Turdus merula	Mëllenja e zezë	-	Kudo
–	Parus lugubris	Trishtili i murrmë	-	Dushkaja

Nr	Emri latin	Emri shqip	Përhapja
–	Lepus europeus	Lepuri	Në gjithë territorin
–	Erinaceus concolor	Iriqi	Në gjithë territorin
–	Capreolus capreolus	Kaprolli	Larg qëndrave të banuara
–	Canis lupus	Ujku	Larg qëndrave të banuara
–	Vulpes vulpes	Dhelpra	Nëe gjithë territorin
–	Sus scrofa	Derri i egër	Larg qëndrave të banuara

Habitatet ligatinore

Habitatet e ligatinave përfshijnë ato të lumit të Gjadrit, si dhe të disa përrenjëve kryesorë. Këto janë të dominuar nga lloje të gjinisë së shelgjeve *Salix alba,* etj.

Habitatet ujore janë jetike për tërësinë e kafshëve të ekonomisë pyjore sepse secila prej tyre e ka të domosdoshme përdorimin e përhershëm apo të përkohshëm të rezervave ujore. Pra një përshkrim i gjërë i llojeve që vizitojnë mjediset ujore do të njehsohej me përshkrimin e llojeve të gjithë ekonomisë.

Megjithatë varësia nga një tip habitati ndryshon në funksion të llojit. Disa prej tyre shihen në këto mjedise dhe cilësohen si të lidhur ngushtësisht me mjediset ujore. Ndër më të zakonshmit janë amfibet që nuk jetojnë dot larg mjediseve ujore. Grupet e tjera si reptilet, shpendet apo dhe gjitarët përbëjnë një tjetër komunitet të tanishëm por gjithsesi më të rrallë.

Amfibët

Vlerësimi i amfibëve u bazua në vrojtime direkte si dhe në shqyrtimin e biblografisë ekzistuese. Vrojtimet tona si dhe krahasimi me të dhënat e zonave ndërkufitare me ekonominë pyjore flasin për mundësinë në këtë zonë të disa llojeve të amfibëve.

Amfibët e vrojtuar dhe të pritshëm në habitatet ujore të ekonomisë pyjore "Brinjat e Kreshtës":

Nr	Emri latin	Emri shqip
–	Bufo bufo	Thithlopa
–	Rana balcanica	Bretkoska e zakonshme
–	Rana graeca	Bretkoska e përrenjëve
–	Salamandra salamandra	E bukura e dheut

Reptilet

Reptilet ujore shfrytëzojnë pothuajse të gjithë habitatet ujore që përshkojnë më së miri territorin e ekonomisë. Dy lloje reptilësh janë tipikë për këtë ekonomi.

Reptilet e habitateve ligatinore te ekonomisë pyjore "Brinjat e Kreshtës"

Nr	Emri latin	Emri shqip
–	Natrix natrix	Gjarpëri i madh i ujit
–	Natrix tessellata	Gjarpëri i vogël i ujit

Shpendët

Ndër shpendët e lidhur me mjediset ujore të lartëpërmendur do të veçohen llojet e mëposhtëm, që bëjnë pjesë në rendin e harabelave dhe që ushqehen me insekte, të cilët lidhen me mjediset ujore.

Shpendët e vrojtuara dhe të pritshme të habitateve ujore të ekonomisë pyjore "Brinjat e Kreshtës"

Nr	Emri latin	Emri shqip
–	Motocilla cinerea	Bishtëlëkundësi
–	Motocilla alba	Bishtëlëkundësi i bardhë
–	Luscinia megarhynchos	Bilbili
–	Cinclus cinclus	Mëllenja e ujit
–	Ficedula hypoleuca	Mizakapësi i zi

Gjitarët

Gjitarët tipikë ujor nuk janë të pranishëm në territorin e ekonomisë pyjore "Brinjat e Kreshtës".

5.7. Prania e vlerave konservuese të larta (VKL)

Prania e Vlerave Konservuese të Larta (VKL) për ekonominë e marrë në studim dhe identifikimi i tyre janë si më poshtë;

- VKL1: Diversiteti i specieve ku përfshihen shpendët

- Lakuriqi i natës veshgjatë i zakonshëm (Plecotus Austriacus)
- Bufi (Bubo Bubo)

Bimët e kërcënuara janë:

- Arra (Juglans Regia)
- Gështenja (Castanea Sativa)
- Lajthia e egër (Corylus colurna)

5.8. Rreziqet për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin

Në ekonominë e marrë në studim gjëndja e elementëve ekzistues të biodiversitetit është përgjithësisht e mirë dhe gjatë zbatimit të Planit të Marështimit nuk paraqiten rreziqe ndaj tyre.

5.9. Mundësitë për aktivitetet didaktike dhe kërkime shkencore

Nuk zhvillohen aktivitete didaktike dhe shkencore.

6. ANALIZA E PYJEVE DHE KULLOTAVE

6.1. ANALIZA E TË DHËNAVE PËR PYJET

6.1.1. Analiza e tipeve të pyjeve

Në ekonominë Brinjat e Kreshtës tipet e pyjeve brënda zonës pyjore të ndara sipas kategorive po i rendisim në tabelën 6.1.1.1. si më poshtë vijon:

tabela 6.1.1.1.

Tipet e grumbullit (pyjeve) aktual dhe përqindja ndaj totalit të sipërfaqes

***Ekonomia pyjore* : Brinjat e Kreshtës**	**ha**	**% ndaj sip pyjore**	**% sip totale(FP)**
Pyje të dominuar nga Gështenja	60.26	1.9	1.3
Pyje me Pishë të zezë	644.91	20.3	14.2
Pyje shpardhi me dushqe të tjerë	1763.6	55.7	38.8
Pyje me qarr	7.1	0.2	0.2
Pyje qarri me dushqe të tjerë	115.3	3.6	2.5
Pyje shkurre tëe dominuar nga dushqet	580.4	18.3	12.8
Sipërfaqe pyjore	**3171.5**		
Sipërfaqe totale e Fondit Pyjor (FP)	**4547.1**		

Siç shihet nga tabela pyjet e dominuar nga llojet Shpardh dhe Qarr zënë sipërfaqen më të madhe ndaj sipërfaqes pyjore dhe fondit pyjor të ekonomisë me 1886 ha ose 59.5 % të sipërfaqes pyjore dhe 41.5% të sipërfaqes së fondit pyjor.

Në vijim jepet Analiza e tipeve të pyjeve (tabela 6.1.1.2.) për secilën parcelë dhe nënparcelë ku përfshihen sipërfaqja, forma e qeverisjes, volumi në m^3/ha dhe volume total në m^3.

Analiza e tipeve të pyjeve *tabela 6.1.1.2.*

Parcela	Kodi unik	T i pyllit	Sip ha	Kl moshe	Qeverisja	Vol m^3/ha	Vol T m^3
4	LE08 00 004	GQCQ	181.2	2	SHKURRE	0	0
5	LE08 00 005	GQCQ	37.62	2	SHKURRE	2.3	86.5
12a	LE08 00 012a	GQCQ	44.14	2	SHKURRE	3.7	163.3
12b	LE08 00 012b	GQFQ	12.39	3	CUNGISHTE	18.1	224.3
14a	LE08 00 014a	GCBF	6.77	2	SHKURRE	7	47.4
14c	LE08 00 014c	GQFQ	27.35	3	CUNGISHTE	21.2	579.8
15	LE08 00 015	GQFQ	15.25	3	CUNGISHTE	21	320.3
16a	LE08 00 016a	GQFQ	15.22	3	CUNGISHTE	21.4	325.7
16b	LE08 00 016b	GQFQ	12.34	3	CUNGISHTE	21.7	267.8
16c	LE08 00 016c	GQFQ	24.86	3	CUNGISHTE	21.1	524.5
17	LE08 00 017	GQFQ	30.62	2	SHKURRE	0	0.0
18a	LE08 00 018a	GQFQ	34.13	3	CUNGISHTE	20.5	699.7
18b	LE08 00 018b	GQFQ	25.11	2	SHKURRE	0	0.0
19a	LE08 00 019a	GQFQ	21.71	3	CUNGISHTE	15.3	332.2
20	LE08 00 020	GQFQ	65.83	3	CUNGISHTE	22	1448.3
21	LE08 00 021	GQFQ	39.81	3	CUNGISHTE	20.9	832.0
22a	LE08 00 022a	GQFQ	12.11	3	CUNGISHTE	20	242.2
22b	LE08 00 022b	GQFQ	27.76	3	CUNGISHTE	18.5	513.6
22c	LE08 00 022c	GQFQ	16.96	3	CUNGISHTE	17.6	298.5
23a	LE08 00 023a	GQFQ	14.56	3	CUNGISHTE	20.7	301.4
23b	LE08 00 023b	GQFQ	37.54	3	CUNGISHTE	18	675.7
28a	LE08 00 028a	GQFQ	19.72	3	CUNGISHTE	17	335.2
28b	LE08 00 028b	GCS	26.65	4	TRUNGISHTE	146.8	3912.2
28c	LE08 00 028c	GQFQ	31.13	3	CUNGISHTE	18.8	585.2
29a	LE08 00 029a	GQFQ	38.89	3	CUNGISHTE	16.8	653.4
29b	LE08 00 029b	GQFQ	24.22	3	CUNGISHTE	17.9	433.5
30a	LE08 00 030a	GQFQ	12.99	3	CUNGISHTE	17.6	228.6
31a	LE08 00 031a	GQFQ	29.12	3	CUNGISHTE	19.4	564.9
31b	LE08 00 031b	GQFQ	18.61	3	CUNGISHTE	17.6	327.5
32a	LE08 00 032a	GQFQ	18.19	3	CUNGISHTE	16.9	307.4
32b	LE08 00 032b	GQFQ	10.12	3	CUNGISHTE	17.7	179.1
32c	LE08 00 032c	GQFQ	15.5	3	CUNGISHTE	15.8	244.9
33b	LE08 00 033b	GQFQ	19.93	2	SHKURRE	0	0.0
34a	LE08 00 034a	GQFQ	22.83	2	SHKURRE	0	0.0
36a	LE08 00 036a	GQFQ	14.72	3	CUNGISHTE	15.3	225.2
37b	LE08 00 037b	GQFQ	13.22	3	CUNGISHTE	19.7	260.4
38	LE08 00 038	GQFQ	45.95	3	CUNGISHTE	16	735.2

39	LE08 00 039	APN	60.64	3	TRUNGISHTE	37	2243.7
40a	LE08 00 040a	GQFQ	23.27	3	CUNGISHTE	19.6	456.1
40b	LE08 00 040b	GQFQ	11.65	3	CUNGISHTE	21.9	255.1
40c	LE08 00 040c	GQFQ	3.61	3	CUNGISHTE	24.5	88.4
42a	LE08 00 042a	GQFQ	52.71	3	CUNGISHTE	20.1	1059.5
43	LE08 00 043	GQFQ	25.69	3	CUNGISHTE	24.2	621.7
44	LE08 00 044	GQFQ	26.59	3	CUNGISHTE	20.4	542.4
45a	LE08 00 045a	GCSQ	33.61	4	TRUNGISHTE	45.8	1539.3
46a	LE08 00 046a	GQFQ	17.45	3	CUNGISHTE	24.1	420.5
46b	LE08 00 046b	GQFQ	12.34	3	CUNGISHTE	24	296.2
47a	LE08 00 047a	GQFQ	9.78	3	CUNGISHTE	19.6	191.7
47b	LE08 00 047b	GQFQ	59.38	3	CUNGISHTE	25	1484.5
48a	LE08 00 048a	GQFQ	103	3	CUNGISHTE	23.8	2451.4
53a	LE08 00 053a	GQFQ	42.4	3	CUNGISHTE	21.7	920.1
54a	LE08 00 054a	GQFQ	5.83	3	CUNGISHTE	19.7	114.9
54b	LE08 00 054b	GQFQ	4.82	3	CUNGISHTE	21.9	105.6
55	LE08 00 055	GQFQ	22.66	3	CUNGISHTE	19.1	432.8
56a	LE08 00 056a	GQFQ	40.1	3	CUNGISHTE	21.7	870.2
56b	LE08 00 056b	GQFQ	15.6	3	CUNGISHTE	18.5	288.6
57a	LE08 00 057a	GQFQ	9.13	3	CUNGISHTE	23.4	213.6
57b	LE08 00 057b	GQFQ	48.65	3	CUNGISHTE	21.7	1055.7
57c	LE08 00 057c	GQFQ	3.27	3	CUNGISHTE	18.5	60.5
58a	LE08 00 058a	GQFQ	39.76	3	CUNGISHTE	17.6	699.8
59a	LE08 00 059a	GQFQ	4.71	3	CUNGISHTE	16.5	77.7
59b	LE08 00 059b	GQFQ	7.04	3	CUNGISHTE	22.4	157.7
59c	LE08 00 059c	GQFQ	13.69	3	CUNGISHTE	18.1	247.8
59d	LE08 00 059d	GQFQ	14.49	3	CUNGISHTE	27.5	398.5
60a	LE08 00 060a	GQFQ	33.97	3	CUNGISHTE	20.3	689.6
60b	LE08 00 060b	GQFQ	12.12	3	CUNGISHTE	17.3	209.7
61a	LE08 00 061a	GQFQ	37.46	3	CUNGISHTE	19.3	723.0
62a	LE08 00 062a	GQFQ	42.98	3	CUNGISHTE	27.8	1194.8
62b	LE08 00 062b	GQFQ	4.45	3	CUNGISHTE	23.4	104.1
63a	LE08 00 063a	GQFQ	18.22	3	CUNGISHTE	17.7	322.5
63b	LE08 00 063b	GQFQ	11.92	3	CUNGISHTE	18.8	224.1
64a	LE08 00 064a	GQFQ	26.27	3	CUNGISHTE	18.3	480.7
64b	LE08 00 064b	GQFQ	4.26	3	CUNGISHTE	18.7	79.7
64c	LE08 00 064c	GQFQ	5.14	3	CUNGISHTE	23.7	121.8
66a	LE08 00 066a	GQFQ	55.24	3	CUNGISHTE	17.6	972.2
66b	LE08 00 066b	GQFQ	14.84	3	CUNGISHTE	16.6	246.3
67b	LE08 00 067b	GQFQ	6.17	3	CUNGISHTE	24	148.1
68a	LE08 00 068a	APN	45.05	4	TRUNGISHTE	122.9	5536.6

69	LE08 00 069	APN	50.42	4	TRUNGISHTE	40.2	2026.9
72	LE08 00 072	APN	47.66	4	TRUNGISHTE	43.2	2058.9
74	LE08 00 074	DQT	75.38	2	SHKURRE	0	0.0
79	LE08 00 079	GQFQ	74.97	3	CUNGISHTE	19.4	1454.4
80	LE08 00 080	DQT	25.73	2	SHKURRE	0	0.0
81	LE08 00 081	GQFQ	50.33	3	CUNGISHTE	18.3	921.0
82	LE08 00 082	GQFQ	45.56	3	CUNGISHTE	19.3	879.3
87a	LE08 00 087a	GQC	7.07	3	CUNGISHTE	18.3	129.4
87b	LE08 00 087b	GQCQ	2.74	2	SHKURRE	0	0.0
87c	LE08 00 087c	GQCQ	18.6	3	CUNGISHTE	20.9	388.7
91a	LE08 00 091a	APN	69.45	4	TRUNGISHTE	45.5	3160.0
92a	LE08 00 092a	DQT	17.4	2	SHKURRE	0	0.0
92b	LE08 00 092b	DQT	8.04	2	SHKURRE	0	0.0
93b	LE08 00 093b	GQFQ	28.77	3	CUNGISHTE	18.4	529.4
94	LE08 00 094	GQFQ	44.66	3	CUNGISHTE	17	759.2
95	LE08 00 095	GQFQ	55.13	3	CUNGISHTE	25.8	1422.4
97a	LE08 00 097a	APN	24.11	4	TRUNGISHTE	43.2	1041.6
97b	LE08 00 097b	APN	4.33	4	TRUNGISHTE	40.4	174.9
98a	LE08 00 098a	APN	76.07	4	TRUNGISHTE	36	2738.5
99a	LE08 00 099a	APN	40.03	4	TRUNGISHTE	60.8	2433.8
100	LE08 00 100	APN	28.19	4	TRUNGISHTE	51.6	1454.6
101	LE08 00 101	APN	13.33	4	TRUNGISHTE	35.7	475.9
102	LE08 00 102	APN	49.21	4	TRUNGISHTE	59.5	2928.0
103	LE08 00 103	APN	41.93	4	TRUNGISHTE	56.8	2381.6
104	LE08 00 104	APN	72.82	4	TRUNGISHTE	62.7	4565.8
105	LE08 00 105	DQT	82.87	2	SHKURRE	0	0.0
106a	LE08 00 106a	APN	21.67	4	TRUNGISHTE	41	888.5
			3171.5				**78036.1**

Sikurse shihet dhe nga tabela e mësipërme në këtë ekonomi dominojnë Trungishtet me llojet Pishë e Zezë dhe Gështenjë, të cilat kanë edhe volumin më të madh të materialit drusor.
Të dhëna të plota të përpunuara nga programi i bashkëlidhen këtij raporti.

6.1.2. Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas formës së qeverisjes

Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas formës së qeverisjes për ekonominë e marrë në studim është e ndarë si më poshtë:
Pyje gjithsej janë 3171.5 ha dhe volum 78036.1m^3 nga të cilët;

- Trungishte 705.2 ha, me volum 39560 m^3,
- Cungishte 1886 ha, me volum 38177 m^3;

dhe Shkurre 580.4 ha, me volum 292.2 m^3.

Të dhënat pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm.



Siç shihet nga grafiku volumin më të madh e japin Trungishtet me 39560 m3 dhe më pas cungishtet me funksion prodhues.

6.1.3. Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimit

Sipërfaqja totale sipas formës së qeverisjes kundrejt klasave të moshës është si më poshtë vijon:

Emërtimi	Sipërfaqja (ha)	Klasa e moshës
Trungishte	705.2	4
Cungishte	1886.0	3
Shkurre	580.4	2
	3171.5	

Volumi për hektar sipas formës së qeverisjes kundrejt klasave të moshës është si më poshtë vijon:

Emërtimi	Volumi për (ha)	Klasa e moshës
Trungishte	56.0	4
Cungishte	20.2	3
Shkurre	0.5	2

Të dhëna specifike të plota për çdo parcelë dhe nënparcelë për sipërfaqen e specieve në raport me klasat e moshës, volumin e tyre, sipërfaqen totale për klasa prodhimi, sipërfaqen dhe volumin sipas klasave të prodhimit jepet në tabelën **nr.22/6 "Të dhënat kryesore sipas parcelave dhe n/parcelave"** bashkëlidhur materialit.

6.2. ANALIZA E TË DHËNAVE TË KULLOTAVE

6.2.1 Gjëndja e kullotave

Në planin e mëparshëm ishin 437.8 ha kullota, sipas këtij plani gjëndja aktuale e kullotave është e njëjtë. Nuk kemi ndryshim në sipërfaqe, por vërehet një degradim i kullotave për të cilat janë parashikuar masat e nevojshme në mënyrë që të bëhet përmirësimi i tyre në vitet në vijim. Gjithashtu është planifikuar ndërtimi i disa Lerave për mbledhjen e ujit që do shërbejë për kafshët në kullotë.

7. REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

7.1.1. Rezultatet e Inventarizimit të Pyjeve

Treguesit kryesorë statistikorë që analizohen janë shmangja tip S që tregon luhatjen e vlerave të sipërfaqeve provë ndërmjet njëra-tjetrës

Numëri i domosdoshëm i sipërfaqeve provë për klasë moshe dhe tip grumbulli llogaritet me anë të formulës **N={(CV*T)/E}2** ku:

CV = koeficienti i varacionit deri në 30%

T = shkalla e lirisë (për P = 95%, T = 2) ku P = probabiliteti.

E = gabimi standart i lejuar

N = numëri i sipërfaqeve provë

Në bazë të udhëzuesit koefiçenti i varacionit llogaritet për çdo shtresë. Ky koeficient llogaritet mbi bazen e shmangies tip të shtresës pjesëtuar me mesataren e shtreses. Në rast se ky koeficient është më i madh se 30% duhet të shtohen sipëerfaqet prove suplementare dhe të përkohshme.

Numëri maksimal i sipërfaqeve provë në një ngastër është i barabarte me sipërfaqe të përherëshme + sipërfaqe të përkohshme + sipërfaqet suplementare.

Gjithashtu në bazë të manualit numri i domosdoshëm i sipërfaqeve provë varion në bazë të sipërfaqeve të n/ngastrave kështu që kemi:

- Ngastra me sipërfaqe deri në 4 ha nevojiten 5 sip prove.
- Ngastra me sipërfaqe deri në 10 ha nevojiten 7 sip prove.
- Ngastra me sipërfaqe mbi 10 ha nevojiten 10 sip prove.

Duke patur parasysh kërkesat e mësipërme del se numri i sipërfaqeve provë të marra për inventarizimin e grumbujve të kësaj ekonomie janë mëse të mjaftueshme.

Në foton nr.7.1.1.1, jepen aspekte nga puna e terrenit për grumbullimin e të dhënave në sipërfaqet prove të përhershme dhe të përkohshme;

Aspekte nga puna për grumbullimin e të dhënave *Foto nr.7.1.1.1.*

Parametrat e siguruara nga programi MS Access dhe rezultatet e përpunimit statistikor janë si më poshtë vijon:

Shtresa (Tipi i grumbullit)	Nr. Sip provë	Dev. standart	m^3/ha (mesatare)	Devijimi standart në %	Gabimi standart	Gabimi standart në %
CCCCGQFQ	1		28.5			
CCCD	2	1.6	31.0	5.0	1.1	3.6
CCCDGQC	2	1.4	18.3	7.9	1.0	5.6
CCCDGQCQ	27	6.3	17.7	35.4	1.2	6.8
CCCDGQFC	1		17.9			
CCCDGQFQ	379	9.0	21.0	42.7	0.5	2.2
HHHCAPN	1		0.0			
SSSD	3	0.0	0.0	#Num!	0.0	#Num!
SSSDDQT	42	28.0	4.3	648.1	4.3	100.0
SSSDGCBF	2	0.0	0.0	#Num!	0.0	#Num!
SSSDGQCQ	61	2.8	1.0	279.7	0.4	35.8
SSSDGQFQ	34	30.2	5.8	523.0	5.2	89.7

Të dhëna të detajuara jepen bashkëlidhur materialit të dala nga përpunimi i të dhënave.

7.1.2. Volumi dhe rritja në volum e grumbujve pyjor

Volumi në këmbë është llogaritur për secilën parcelë dhe nënparcelë dhe specie për 1 (një) ha dhe për komplet sipërfaqen e ekonomisë pyjore sipas programit access.

Gjithashtu volumi në këmbë është i ndarë në asortimente dimensionale; lëndë punimi (lëndë e hollë, e mesme, e trashë), dru zjarri, dhe mbeturina, për 1 (një) ha për secilën nënparcelë dhe specie

sipas kategorive diametrike, po kështu edhe rritja mesatare dhe rritja vjetore.

Të dhëna të plota, të detajuara për çdo nënparcelë për sa më sipër jepen në tabelën **nr.23c "Fuqia lëndore sipas llojeve dhe asortimenteve për ha dhe n/parcelë"** bashkëlidhur materialit.

7.1.3. Struktura Vertikale

Struktura e grumbujve pyjore të ekonomisë së marrë në studim janë të gjithë një katësh sipas përshkrimit parcelar. Gjëndja e ripërtëritjes në pyjet artificialë me Pishë të Zezë është premtuese ndonëse e shfaqur kjo me vatra të veçanta, me 2-3 filiza për m^2, pasi ka filizëri të instaluar nga farat e tyre, pra mund të themi se ka përshtatje dhe rigjenerim natyral për të ardhmen. Po kështu edhe sipërfaqet me cungishte në sajë të masave të përcaktuara në këtë plan dhe kryesisht mbrojtja e tyre nga dëmtimi përbën faktorin kyç jo vetëm për mirërritjen e tyre por edhe shtim gradual të cungishteve përmes zbatimit rigoroz të punimeve përmirësuese në llojet Shpardh Qarri etj, që përbëjnë bazën e rritjes së volumit në cilësi dhe në sasi të cungishteve.
Të dhëna të plota për çdo nënparcelë për strukturën vertikale jepen në tabelën **nr.26a "Struktura vertikale e grumbujve pyjorë"** si dhe në skedën e përshkrimit parcelar bashkëlidhur materialit.

7.1.4. Cilësia e materialit drusor

Ekonomia e marrë në studim përgjithësisht nuk ka lëndë të cilësisë së mirë, sepse vetë grumbujt pyjorë ku dominojnë shkurret nuk e presupozojnë këtë fakt.
Po kështu edhe pyjet e Pishës së Zezë që rezultojnë nga pyllëzimet artificiale nuk kanë zhvillim të mirë, pasi janë me trung të shkurtër dhe të pa diferencuar, me degëzime të shumta duke filluar nga baza e trungut, me lartësi të vogël, e theksuar kjo dukuri sidomos në pjesët e sipërme të parcelave dhe nënparcelave ku bëhen me trup më të shkurtër si pisha "Xhuxh.
Por është për t'u theksuar se ka filluar përshtatja e tyre dhe aklimatizimi, pra ka mbirje të reja përmes farave të pishave, fakt premtues ky për zhvillim të natyrshëm të halorëve në të ardhmen.
Për cungishtet mund të themi se janë në fazën e parapjekurisë dhe janë përgjithësisht me cilësi të mirë zhvillimi dhe seleksionimi. Ndihmë për ecuri të mëtejshme do jenë edhe masat e marra për kryerjen e punimeve përmirësuse në këta grumbuj.

7.1.5. Biomasa dhe Faktorët e Ekspansionit të Biomasës

Sipas përcaktimit të dhënë në Direktiven 2009/28/CE, biomasa është "fraksioni biodegradues i produkteve, mbetjeve dhe mbeturinave me origjinë biologjike nga bujqësia (përfshirë substancat e bimëve dhe kafshëve), pylltaria dhe industritë përkatëse që përfshijnë peshkimin dhe akuakulturën, si dhe fraksioni biodegradues i mbetjeve industriale dhe bashkiake.
Nënproduktet e pyjeve janë e gjithë biomasa që e ka origjinën nga pyjet. Në fakt vlerësimi i furnizimeve me burime është kompleks dhe "Furnizimi me burime potenciale" është një koncept i ndryshëm nga "Furnizimi me burime të disponueshme dhe të qëndrueshme" dhe shpesh

parashikon një furnizim të mirë me biomasë të disponueshme, por nëse realizohen zinxhirët e bioenergjisë, vetëm një pjesë e vogël e totalit të biomasës së disponueshme mund të përdoret në kushtet e qëndrueshmerisë.
Pyjet janë burim shumë i rëndësishëm i prodhimit të biomasës. Së pari, biomasa është energji. Lënda drusore zë rreth 35-40% të energjisë për ngrohje në banesa, kryesisht në zonat rurale. Biomasa është lënda e parë, e cila është më e përshtatshme për marrjen e njëkohëshme të energjisë elektrike dhe termike (ngrohje), pra arrihet i ashtuquajturi bashkëprodhim (kogjeneration). Së dyti, biomasa na rrethon kudo – në mbetjet e ekonomive pyjore, në bujqësi, në akuakulturë, në zonat ligatinore (kallamishtet), në jetën tonë të përditshme, etj. Kjo është dhe një nga përparësitë e saj kryesore, sepse instalimet për energji termike ose elektrike të biomasës janë kryesisht lokale, shumë afër konsumatorit. Në këtë këndvështrim, ekosistemet pyjore, shkurretat mund të nxjerrin fitime nga përdorimi i biomasës, nëse mirëmenaxhohen në mënyrë të integruar dhe të qëndrueshme.
Sipas përllogaritjeve për ekonominë e marrë në studim, si biomasë në dispozicion për plotësimin e nevojave energjitike mund të merret vëllimi i materialit drusor që del nga masat e marra dhe të planifikuara për dhjetë vitet që zbatohet ky Plan Mbarështimi, si punimet përmirësuese në Cungishte me volum 9434m^3, kryesisht dru zjarri, ose 943.4m3/vit.

7.1.6. Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e karbonit

Ashtu si në mbarë vendin edhe në ekonominë e marrë në studim pyjet gjithnjë e më shumë po marrin rëndësi të madhe jo vetëm për lëndën drusore dhe për prodhimet jo drusore; por për ndikimin e madh të pazëvendesueshëm në sekuestrimin e karbonit: biodiversitet, shendet, ekonomi dhe turizëm.
Pyjet janë të ndjeshëm ndaj klimës, ndryshimet klimatike do ndikojnë në dinamikën e ekosistemit. Ndryshimet e temperaturës dhe reshjeve mund të ndikojnë në suksesin e llojeve të ndryshme vendase dhe të huaja.
Drurët pyjorë të veçuar apo si pyll, kanë një potencial të madh për të rivendosur ekosistemet e degraduara, për të siguruar ushqim, produkte mjekësore dhe mallra të tjera që kontribuojnë në shëndetin e njeriut. Vetëm pyjet mundësojnë shërbime mjedisore si: mbrojtje nga rrezatimi diellor, mbrojtjen e ajrit nga ndotja, mbrojtje nga erërat dhe zhurma. Vetëm mjedisi pyjor arrinë të krijojë një mikroklimë të përshtatëshme për njerëzit dhe faunën, mbrojtjen e burimeve ujore dhe të pjellorisë së tokës, parandalimin e erozionit të tokës, zbutjen e ndryshimeve klimatike. Pyjet dhe drurët pyjor në mjediset urbane, konsiderohen sot si mjeti më i mirë; për të luftuar stresin e qënieve njerëzore, për të përmirësuar mirëqënien psikologjike, në proceset e shërimit me shpejtësi dhe rritje të kapacitetit mendor.
Nëpërmjet realizimit të procesit të fotosintezës, drurët dhe bimët e tjera të pyllit thithin nga ajri gazin karbonik (CO2) dhe clirojnë oksigjen (O2). Gazi karbonik, gazi kryesor i efektit 'serrë', pra i mbingrohjes globale, jo vetëm fiksohet prej drurëve të pyllit, por njëherësh ky gaz depozitohet për një periudhë të gjatë kohe në dru (sa është jeta e drurit me këmbë në pyll dhe për një pjesë të

lëndës së drurit edhe për sa kohë akoma ajo përdoret në industri, jo për djegie), bëhet fjalë për dhjetra e qindra vjet. Është ky arsyetimi bazë që pyllit i atribuohet vetia e sekuestrimit të karbonit. Nëpërmjet realizimit të transpiracionit (avullimi i ujit prej gojëzave që ndodhen në pjesën e poshtme të gjetheve të drurëve) dhe intercepsionit (avullimi i ujit të reshieve prej sipërfaqeve të gjetheve të drurëve) pylli ushqen ajrin me avuj uji.

- Kurorat e drurëve të pyllit mbajnë mbi vetë një masë të konsiderueshme të pluhurit të ajrit, që me pas përcillet në tokë prej ujit të reshieve.
- Nëpërmjet absorbimit në një masë të konsiderueshme të prej ujit të reshieve . të oksideve të azotit, të amoniumit të cilët janë pergjegjes për krijimin e ozonit nëpërmjet një zinxhiri reaksionesh, pylli frenon krijimin e ozonit në shtresën e poshtme të troposferës, në shtresën e biosferës pra, ku ai (ozoni) si një oksidant shumë agresiv, rezulton i dëmshëm për njeriun dhe botën e gjallë në përgjithësi.
- Kurorat e drurëve të pyllit fiksojnë gjithashtu mjaft jone e atome të metaleve të rëndë, që konsiderohen lëndë toksike të rrezikshme për shëndetin e njeriut (përmenden këtu arseniku, kadmiumi, plumbi, etj), si edhe gazra si dioksidi i squfurit, etj.

Sa më sipër në ekonominë e marrë në studim për 705.2 ha trungishte, me rritje mesatare 1456 m^3/vit, llogaritet të sekuestrohet rreth 1829 ton CO_2/vit, për 1886 ha cungishte, me rritje mesatre 1749.3 m^3/vit, llogaritet të sekuestrohet rreth 2197 ton CO_2/vit dhe për 580.4 ha shkurre, me rritje mesatare 265.4 m^3/vit, llogaritet të sekuestrohet rreth 333.4 ton CO_2/vit, për gjithë ekonominë sasia e dioksidit te karbonit të sekuestruar është 4359.4 ton x 3.66 (kefiçient)= 15955.4 ton CO_2/vit.

Ky sekuestrim i kundërvihet mbindotjes se atmosferës me gazin karbonik të cliruar prej gjithë veprimtarive të drejtpërdrejta ose jo të njeriut mbi mjedisin.

7.2. Gjëndja shëndetsore dhe fitosanitare

7.2.1. Drurët e tharë

Në ekonominë pyjore Brinjat e Kreshtës, vërehen në masë të pakonsiderueshme drurë të tharë sidomos në pyllëzimet artificiale me Pishë të Zezë nën influencën e faktorëve të ndryshëm natyrorë dhe subjektiv; si kushtet atmosferike, shkaqe të panjohura; si dhe nga veprimtaria e pakujdesshme e njeriut.

E rëndësishme është të theksohet se ky fenomen nuk ndikon negativisht në biodiversitet dhe gjëndjen shëndetsore të grumbujve pyjorë në përgjithësi.

7.2.2. Dëmtimet e tjera

Ndër dëmtimet e tjera, përmendim dëmtime të vegjetacionit në më pak se (< 6%) të sipërfaqes nga shkaqe të panjohura dhe neglizhim në përkujdesje. Duke qënë në sasi mjaft të vogla nuk kanë ndikim dhe pasoja mbi ekosistemet pyjore dhe mbarështimin e pyjeve.

7.3. Prerjet e paligjshme

7.3.1. Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet në proçesin e planifikimit

Në ekonominë e marrë në studim janë konstatuar prerje sporadike në pyjet e dushqeve nga popullata e zonës. Ky fenomen ka ardhur duke u frenuar gradualisht dhe supozohet që nuk përbën problem për ecurinë e grumbujve pyjorë.

7.3.2. Impakti i prerjeve ilegale në planifikimin dhe mbarështimin e pyjeve

Përgjithësisht sipërfaqja pyjore dhe sidomos sipërfaqet me shkurre kanë pësuar ulje edhe pse shpyllëzimi dhe ulja e presionit ndaj sipërfaqeve të zhveshura apo atyre me bimësi pyjore ka bërë që tek këto dy grupe territoresh të zhillohet dhe të shtohet gradualisht vegjatacioni potencial pyjor i përfaqsuar nga shkrret mesdhetare, ku mbizotërojnë sipas rasteve, Bulgëri, Shqopa, Shqemja, Dëllinja, Frashër i Bardhë, etj,.
Ndalimi i shpyllëzimeve të mëtejshme, tjetërsimi i sipërfaqeve pyjore dhe shkurreve është tashmë sfidë e madhe për ruajtjen e mjedisit pyjor në veçanti si kusht i domosdoshëm i zbatimit konkret te Planit të Mbarështimit.

7.4. Rezultatet e Inventarizimit te Kullotave

7.4.1. Tipi dhe cilësia e kullotave

Ashtu siç e kemi theksuar edhe më sipër në këtë ekonomi janë vetëm 437.8 ha livadhe në të cilat kulloten kryesisht në verë.

7.4.2. Përdoruesit e kullotave dhe koha

Këto kullota janë pronë shtetërore dhe shfrytëzohen nga fshatrat që i kanë më afër.

7.4.3. Llojet e bagëtive

Janë përmendur në të dhënat që kanë rezultuar nga llogaritjet e programit të cilat i bashkëlidhen raportit.

7.4.4. Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kullotave

Janë përmendur në të dhënat që kanë rezultuar nga llogaritjet e programit të cilat i bashkëlidhen raportit.

7.4.5. Infrastruktura aktuale

Janë përmendur në të dhënat që kanë rezultuar nga llogaritjet e programit të cilat i bashkëlidhen raportit.

8. OBJEKTIVAT E MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

8.1.Objektivat e përgjithshme për planifikimin afatgjatë

Pyjet janë një pasuri dhe trashëgimi e çmueshme kombëtare. Në Nenin 1 të Ligjit Nr. 57/2020, datë 30.04.2020 Për Pyjet thuhet: "Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, të tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime me interes kombëtar dhe ndërkombëtar". Bazuar sa më sipër, si dhe sipas parimeve të mbarështimit të qëndrueshëm e shumë funksional, është realizuar optimizimi i nevojave lokale me mundësitë/kapacitetet ekologjike. Gjatë hartimit të PMPK, u krye studimi i territorit, marrja e të dhënave, taksacioni pyjor, si dhe takime me grupe interesi me synim:

- Bashkërendim me aktorët lokalë që veprojnë në zonë edhe me dy – tre ekonomi pyjore fqinje, për të ndaluar prerjet abusive e degradimin e pyjeve.
- Përfshirje dhe angazhim i aktorëve lokalë, grave e grupeve të disavantazhuara më hartimin dhe zbatimin e PMPK.
- Mbrojtje e përmirësim të mjedisit të përbashkët.
- Reduktimi i varfërisë në zonat rurale.
- Trajnim profesional i aktoreve në pyje, në të gjitha nivelet (punëtorë, teknike, udhërrëfyes të guidave të natyrës)
- Përdorim i zhvillimit natyral të pyjeve (automatizimi biologjik)
- Rehabilitim e përmirësim i sipërfaqeve pyjore, për mbrojtjen e ekosistemeve natyrore, përmirësim të peisazhit rural dhe ruajtja e biodiversitetit.
- Mirëmenaxhim i qëndrueshëm e shumë funksional i pyjeve e kullotave.
- Përmirësim në përdorimin e territorit, të formës së qeverisjes, përmirësim të shkurreve, konvertim të tyre në cungishte dhe cungishteve ekzistuese në trungishte.
- Përdorimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve mbi bazën e vlerësimit me kritere bashkëkohore të gjendjes biologjike dhe ekologjike të tyre në mënyrë që të përcaktohet realisht potenciali i tyre prodhues, pa dëmtuar biodiversitetin dhe problemet e mbrojtjes së mjedisit.
- Përcaktimi i rolit dhe mënyrës së përfshirjes së palëve të interesuara gjatë hartimit dhe zbatimit të këtij plani.

8.2. Objektivat kombëtare për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave, Pajtueshmëria e PMPK me planifikimin rajonal dhe atë në nivel Bashkie

Sipas Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), parashikohet realizimi i një brezi prej 2 mln drurë (pemë), me synim bllokimin e konsumit të tokës dhe krijimin e një unaze me pemë frutore, parqe me pemë dhe pyje për natyralizim. Pra PPV i Lezhës ka për qëllim të kufizojë konsumin e tokës, të ruajë zonat bujqësore dhe natyrore, duke parashikuar ku të jetë e nevojshme rinatyralizimin e tyre.

PPV propozon krijimin e hapësirave të gjelbërta, si një kufi hije bërës të zonës urbane, si një kufi natyral ndaj rritjes urbane.
Në hartimin e PMPK, janë marrë parasysh, prioritetet e PPV, edhe për përdorime multifunksionale të pyjeve dhe hapësirave të gjelbëra. Multifunksionaliteti i bujqësisë, të stimulohet si tipar themelor i zhvillimit të një politike të përbashkët bujqësore.

8.3. Objektivat kryesore të PMPK

Plani i Mbarështimit të Ekonomisë pyjore Brinjat e Kreshtës, ka disa objektiva kryesore:

- Është synuar që të merren në konsideratë të gjithë faktorët që lidhen direkt ose indirekt ndërmjet tyre – popullata lokale, administrimi i pyjeve dhe kullotave, ekoturizmi, interesi që ofron pylli, blegtorët etj, pa harruar kufizimin e erozionit, ruajtjen e natyrës dhe stabilitetin e resurseve.
- Një objektiv i veçantë është plotësimi i nevojave me material drusor, bazë ushqimore për blegtorinë, si dhe përdorimi i prodhimeve të dyta pyjore vetëm nëpërmjet një zhvillimi të qëndrueshëm të pyjeve. Mbrojtja e ekosistemeve natyrore, përmirësimi i peisazhit rural dhe mbrojtja e biodiversitetit përbën një objektiv të rëndësishëm të projektit, ku zgjerimi i këtyre zonave do të jetë në qëndër të objektivave të veçantë.
- Përfshirja e interesave të komunitetit dhe të pjesëmarrësve të tjerë veprues në territorin e kësaj ekonomie, harmonizimi i këtyre interesave në përputhje me mundësinë aktuale dhe potenciale të pyllit.
- Grumbullimi i informacionit të shumfishtë, evidentimi i faktorëve socialë dhe ekonomikë që ndikojnë në një mbarështim të qëndrueshëm të pyjeve. Informacionet nuk duhet të përshijnë vetëm ato pjesë që kanë të bëjnë me grumbullin pyjor, por të mundësojë vlerësimin e parametrave ekologjikë (klima etj) biologjikë (ekosistemet, biotopet, florën dhe faunën veçanarisht atë të kërcënuar).
- Identifikimi i masave që do të merren në të ardhmën, harmonizimin e të gjithë faktorëve veprues dhe përcaktimin e objektivave specifike që janë rezultat logjik i një mbarështimi bashkëkohor.

8.4. OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË EKONOMISË PYJORE/NJM

8.4.1. Objektivat specifikë mbi përdorimin e tokës, funksionin dhe formën e qeverisjes

Përsa i përket përdorimit të teritorit do të ketë ndryshime nga plani i mëparshëm, për të gjitha arsyet e përmendura e të konkretizuar me tabela e grafikë.(shih kapitullin **2.3**). Pra kemi shtesë në trungishte për 95.34 ha për shkak të vijimit të ripërtëritjes natyrore me pishë të zezë, por edhe të regjistrimit të disa ngastrave trungishte të cilat në vitin 1982 të cilat nuk përputhëshin në kadastër dhe as në Planin e Inventarizimit. Ndërkohë kanë pësuar rënie sipërfaqet prodhuese cungishte, shkurre dhe sipërfaqet joprodhuese.
Funksioni kryesor është ai prodhues, por tendencë zhvillimi ka edhe për funksionin rekreativ.

Në këtë ekonomi do të jenë edhe funksionet specifike e konkretisht: Prodhime drusore-dru zjarri, prodhime drusore lëndë ndërtimi, prodhime qymyr druri, prodhime të dytë – fruta, prodhime të dyta – gjethe, prodhime të dyta – boçe.
Mbrojtja e pyjeve nga zjarret dhe prerjet e paligjshme.

8.4.2. Objektivat specifikë mbi tipet e pyjeve

Tipet e grumbullit si edhe analiza e tyre jepen te **tabela Nr.22, 22/1a** etj, të rezultateve të programit.
Llojet kryesore: Pishë e Zezë, Geshtënjë, Shpardh, Qarr, Bulgër, Frashër i Bardhë, Dëllinjë e Kuqe, Shqopë, Shqeme etj, vëllimi drusor në këmbë i pyjeve të Ekonomisë Brinjat e Kreshtës në total është 78036.1 m^3, vëllimi mesatar/ha i pyjeve trungishte është 56 m^3/ha, Cungishte: 20.2 m^3/ha dhe Shkurre 0.5 m^3/ha.
Për drejtimin e grumbujve drejt normalitetit (fondi real drejt fondit normal) janë propozuar masa konkrete në drejtim të harmonizimit të tre komponenteve (Fond-Strukturë-Gjëndje) të pyllit, përshtatur funksioneve përkatëse nëpërmjet:

- Rritjes së prodhimtarisë të grumbujve pyjor (ndërhyrja me trajtime).
- Përdorimit optimal të stacionit.
- Sigurimit të gjeneratës së re në rrugë natyrore, me prerje rrah e përmirësime.
- Ruajtjes të biodiversitetit të florës e faunës.
- Mbrojtjes të pyjeve nga zjarret dhe prerjet pa leje.
- Rehabilitimit të infrastrukturës rrugore.
- Krijimit të tregut të punës.
- Përmirësimit të gjendjes së përkujdesjes për pyjet.

Për hollësi shih pasqyrat "Tipet e vegjetacionit potencial sipas funksioneve, përqindja ndaj totalit të sipërfaqes pyjore" **tabela nr.13a** dhe "Tipet e grumbullit të propozuar sipas funksioneve, përqindja ndaj totalit të sipërfaqes pyjore" **tabela nr.38**.

8.4.3. Objektivat specifikë silvikultural

Në përshtatje të mjedisit lokal dhe karakteristikave të grumbullit, do të realizojmë sisteme silvikulturale dhe shfrytëzimi optimale.
Do të kryhen një sërë punimesh silvikulturore duke filluar që nga përmirësimet, rrallime te tipit I, prerjet e ndryshme silvikulturore si krasitje në pyjet e Pishës së Zezë. Me anë të tyre synohet përmirësimi i gjendjes aktuale duke gërshetuar të gjithë komponentët së bashku (teknikë dhe socialë).
Do të kryhet një aktivitet silvikultural dhe shpeshtësi ndërhyrjesh në përshtatje me objektivat e mbarështimit, kushtet e stacionit dhe cilësinë e grumbullit.
Të dhëna të hollësishme me shifra paraqiten në tabelën me **40a** dhe **44** "Prerjet e lejuara total Rrallime tipi I dhe "Krasitje" në Trungishte dhe "Përmirësime" më Cungishte.

8.4.4. Objektivat specifik për kullotat

Nga pikpamja e rrezikut të mbikullotjes në pjesët e Ekonomisë pyjore, nuk paraqitet si problem, përveç, disa ngastra në afërsi të zonave të banuara, për të cilat do të tregohet kujdes gjatë punimeve përmirësuese, kryesisht në ngastrat e dushqeve. Tendencë në rritje kanë numri i krerëve të lopëve dhe më pak dhia. Të dhëna për numrin e krerëve sipas disa fshatrave jepen në tabelat e kapitullit **2.6.**

8.4.5. Objektivat specifikë mbi biodiversitetin

Shtrirja e ekonomisë pyjore Brinjat e Kreshtës, nga 170 m mbi nivelin e detit deri 500 m mbi nivelin e detit, ekspzicioni i saj me luginat dhe shpatet e shumtë, rezervuarët e ujit, përrenjtë, përroskat e shumta e bëjnë këtë ekonomi mjaft të larmishme nga pikpamja e biodiversitetit. Në të ardhmen lihet detyrë që të ruhet ky biodiversitet, të mbrohet dhe shtohet, me synim për ta bërë më atraktive zonën, me drejtim zhvillimi, agroturizmin.
Rreziqet për biodiversitetin kanë qënë dhe mbeten shfrytëzimet intensive, prerjet ilgale, mbikullotja në afërsi të fshatrave.
Për përmirësimin e biodiversitetit, të synojmë veçanërisht te llojet dhe varietetet gjenetike.

8.4.6. Objektivat specifikë mbi gjëndjen shëndetsore

Në këtë ekonomi vërehen dëmtime të drurëve kryesisht nga veprimi i erës, veçanërisht në vende të eroduara, kryesisht pishat zeza të pyllëzuara e që kanë arritur moshën mbi 40 vjet, ndikuar kjo edhe nga kushtet e stacionit ndonëse këto nuk janë masive dhe të theksuara.
Dëmtime të tjera të karakterit biologjik vihen re në cungishte që shkurtimisht janë trajtuar më parë.
Prejet ilegale janë problem shqetësues për të ardhmen. Për të frenuar këtë fenomen rekomandohet rritja e përgjegjësisë të personave që merren me mbrojtjen e pyjeve pasi ata pyje që dëmtohen për qëllime fitimi shkaktojnë pasoja të pariparueshme. Përparësi do të kishte, zbatimi rigoroz i ligjit, transferimi i përgjegjësive dhe kompetencave drejt bazës e deri tek përdoruesi i përditshëm. Një gjë e tillë është e parashikuar edhe në strategjinë e zhvillimit të sektorit të pyjeve.

8.4.7. Objektivat specifikë mbi faunën

Ka një numër të konsiderueshëm të faunës së egër, të pranishëm janë: lepuri, thëllëza e malit, pëllumbi, mëllenja, kaprolli, dhelpra, ujku, derri i egër etj. Gjithashtu gjenden Iriqë, breshka.
Prania e tyre tregon për një biodiversitet të kënaqshëm. Zhvillimi i popullatave të tyre nuk ka ndikim negativ mbi ekosistemet pyjore dhe mbi mbarështimin e pyjeve.
Ndër problemet që janë është disiplinimi i kontrollit të gjuetisë i cili duhet të jetë në përputhje më direktivat e ligjit numër 89 datë 12.12.2025 "Për Gjuetinë".

8.4.8. Objektivat specifikë për pyjet me funksion prodhues

Një element i rëndësishëm i funksioneve të veçanta është prodhimi i druve të zjarrit, qymyrit të drurit, nga individë, për të siguruar jetesën.
Sigurimi i druve të zjarrit për ngrohje, është bërë në mënyrë spontane kur dihet se zona përdor si element për ngrohje e gatim drutë e zjarrit.
Për këtë duhet të shfrytëzohen parcelat e përcaktuara me trajtime me përmirësime silvikulturale. Veçanërisht do të trajtohen për dru zjarri drurët që janë të shtrembër (nuk mund të nxirret asortiment), të kalbur, të tharë dhe ata të dëmtuar nga faktorët atmosferikë, duhet detyrimisht që ato parcela që janë planifikuar të shfrytëzohen për prodhimin e druve të zjarrit, për nevojat e komunitetit dhe Enteve publike.
Potencialisht kjo ekonomi ka bimë mjekësore, eterovajore e tanifere (bmet) kokërr (fruti i tyre) që janë një potencial i sigurimit të të ardhurave të banorëve. Për këtë do të respektohen të gjitha kriteret teknike mbi mënyrën e grumbullimit të tyre me qëllim të sigurohet vazhdimësi prodhimi. Përmendim frutin kryesor, Dëllinja e kuqe, Trendafili i egër, Murrizi, etj.

8.4.9. Objektivat specifikë për pyjet me funksion mbrojtës

Nuk ka pyje me funksion mbrojtës në këtë ekonomi.

8.4.10. Objektivat specifikë për pyjet me funksion rekreacioni

Nuk ka pyje me funksion rekreacioni në këtë ekonomi.

8.4.11. Objektivat specifik për pyjet me funksion konservues

Nuk ka pyje me funksion konservues në këtë ekonomi.

9. MASAT/AKTIVITETET E PLANIFIKUARA NË KUADËR TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

9.1.Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit

Ashtu si për çdo ekonomi edhe për ekonominë e marrë në studim rregullimi i proçesit të prodhimit, pavarësisht sistemit silvikulturor të përdorur, siguron bazën e shfrytëzueshmërisë afatgjatë në balancë me rritjen e grumbujve pyjore.
Në këtë ekonomi për vetë natyrën e pyjeve Trungishte dhe Cungishte nuk janë përdorur metodat klasike silvikulturore për llogaritjen e mundësisë vjetore të shfrytëzimit, por janë përcaktuar rigorozisht kategoritë e prerjeve silvikulturore sipas formës së qeverisjes.
Kështu për cungishtet do të kryhen punime përmirësuese dhe për trungishtet do të kryhen krasitje në parcelat të cilat plotësojnë kriteret për ndërhyrje.

9.2. Prerja vjetore silvikulturore

Prerjet silvikulturale për ekonominë pyjore Brinjat e Kreshtës përfshijnë sasinë e volumit të materialit drusor që do të rezultojë nga masat e marra si trajtime silvikulturore për çdo vit brënda planifikimit dhjetë vjeçar, që janë si më poshtë vijon:

9.2.1. Masat silvikulturore në cungishte

Nr.	Kodi unik	Trajtimi silvikulturor	% e sipërfaqes	Sipërf. ha	Intesiteti	Volumi m3	Urgjenca
1	LE08 00 012b	Përmirësime	100	12.4	25	56	3
2	LE08 00 014c	Përmirësime	100	27.4	25	145	3
3	LE08 00 015	Përmirësime	100	15.3	25	80	4
4	LE08 00 016a	Përmirësime	100	15.2	25	82	3
5	LE08 00 016b	Përmirësime	100	12.3	25	67	3
6	LE08 00 016c	Përmirësime	100	24.9	25	131	2
7	LE08 00 018a	Përmirësime	100	34.1	25	175	3
8	LE08 00 019a	Përmirësime	100	21.7	25	83	3
9	LE08 00 020	Përmirësime	100	65.8	25	362	3
10	LE08 00 021	Përmirësime	100	39.8	25	208	3
11	LE08 00 022a	Përmirësime	100	12.1	25	61	3
12	LE08 00 022b	Përmirësime	100	27.8	25	129	3
13	LE08 00 022c	Përmirësime	100	17.0	25	75	2
14	LE08 00 023a	Përmirësime	100	14.6	25	75	3
15	LE08 00 023b	Përmirësime	100	37.5	25	168	2
16	LE08 00 028a	Përmirësime	100	19.7	25	84	1
17	LE08 00 028c	Përmirësime	100	31.1	25	147	1
18	LE08 00 029a	Përmirësime	100	38.9	25	163	1
19	LE08 00 029b	Përmirësime	100	24.2	25	108	2
20	LE08 00 030a	Përmirësime	100	13.0	25	57	3
21	LE08 00 031a	Përmirësime	100	29.1	25	142	3
22	LE08 00 031b	Përmirësime	100	18.6	25	82	3
23	LE08 00 032a	Përmirësime	100	18.2	25	77	3
24	LE08 00 032b	Përmirësime	100	10.1	25	45	3
25	LE08 00 032c	Përmirësime	100	15.5	25	61	3
26	LE08 00 036a	Përmirësime	100	14.7	25	56	2
27	LE08 00 037b	Përmirësime	100	13.2	25	65	1
28	LE08 00 038	Përmirësime	100	46.0	25	184	2
29	LE08 00 040a	Përmirësime	100	23.3	25	114	1
30	LE08 00 040b	Përmirësime	100	11.7	25	64	2
31	LE08 00 040c	Përmirësime	100	3.6	25	22	3
32	LE08 00 042a	Përmirësime	100	52.7	25	264	1
33	LE08 00 043	Përmirësime	100	25.7	25	155	1

34	LE08 00 044	Përmirësime	100	26.6	25	136	1
35	LE08 00 046a	Përmirësime	100	17.5	25	105	2
36	LE08 00 046b	Përmirësime	100	12.3	25	74	3
37	LE08 00 047a	Përmirësime	100	9.8	25	48	2
38	LE08 00 047b	Përmirësime	100	59.4	25	372	3
39	LE08 00 048a	Përmirësime	100	103.0	25	61	1
40	LE08 00 053a	Përmirësime	100	42.4	25	230	1
41	LE08 00 054a	Përmirësime	100	5.8	25	29	2
42	LE08 00 054b	Përmirësime	100	4.8	25	26	2
43	LE08 00 055	Përmirësime	100	22.7	25	108	1
44	LE08 00 056a	Përmirësime	100	40.1	25	218	3
45	LE08 00 056b	Përmirësime	100	15.6	25	72	3
46	LE08 00 057a	Përmirësime	100	9.1	25	53	2
47	LE08 00 057b	Përmirësime	100	48.7	25	263	3
48	LE08 00 057c	Përmirësime	100	3.3	25	15	2
49	LE08 00 058a	Përmirësime	100	39.8	25	175	3
50	LE08 00 059a	Përmirësime	100	4.7	25	19	1
51	LE08 00 059b	Përmirësime	100	7.0	25	39	1
52	LE08 00 059c	Përmirësime	100	13.7	25	62	3
53	LE08 00 059d	Përmirësime	100	14.5	25	100	3
54	LE08 00 060a	Përmirësime	100	34.0	25	172	3
55	LE08 00 060b	Përmirësime	100	12.1	25	52	3
56	LE08 00 061a	Përmirësime	100	37.5	25	181	3
57	LE08 00 062a	Përmirësime	100	43.0	25	298	3
58	LE08 00 062b	Përmirësime	100	4.5	25	26	3
59	LE08 00 063a	Përmirësime	100	18.2	25	81	3
60	LE08 00 063b	Përmirësime	100	11.9	25	56	3
61	LE08 00 064a	Përmirësime	100	26.3	25	121	3
62	LE08 00 064b	Përmirësime	100	4.3	25	20	3
63	LE08 00 064c	Përmirësime	100	5.1	25	30	3
64	LE08 00 066a	Përmirësime	100	55.2	25	243	3
65	LE08 00 066b	Përmirësime	100	14.8	25	62	3
66	LE08 00 067b	Përmirësime	100	6.2	25	37	3
67	LE08 00 079	Përmirësime	100	75.0	25	362	3
68	LE08 00 081	Përmirësime	100	50.3	25	231	3
69	LE08 00 082	Përmirësime	100	45.6	25	220	3
70	LE08 00 087a	Përmirësime	100	7.1	25	32	3
71	LE08 00 087c	Përmirësime	100	18.6	25	97	3
72	LE08 00 093b	Përmirësime	100	28.8	25	133	2
73	LE08 00 094	Përmirësime	100	44.7	25	189	1
74	LE08 00 095	Përmirësime	100	55.1	25	356	3
	TOTAL			**1886**		**9434**	

Siç shihet dhe nga (tab nr.9.2.1) në pyjet cungishte propozohen të kryhen Përmirësime në 1886ha sipërfaqe.

9.3. Planifikimi vjetor i masave

9.3.1. Masat në Pyje

Planifikimi vjetor i ndërhyrjeve_Pyje *tab nr.9.3.1.1*

Men e trajtimit	n/parc	%sip	Sip (ha)	Intensit.	Vol/ha	Vol.T	Viti
Ekonomia Pyjore : Brinjat e Kreshtës							
Rrallim tipi I	08 00 028b	100	26.65	25	29.2	777.5	2027
TOTALI			**26.65**		**29.2**	**777.5**	

9.3.2. Masat në kullota

Masë e domosdoshme për tu zbatuar është përmirësimi i kullotës, ndërtim Lerash dhe mbrojtja e kësaj sipërfaqeje nga dëmtimet e ndryshme dhe sidomos nga veprimtaria e faktorit subjektiv.

9.3.3. Masat në infrastrukturë dhe në zonat e degraduara, rekreacionale dhe didaktike

Nuk janë përcaktuar masa specifike.

9.4. Masat afat-gjata

9.4.1. Masat silvikulturale në trungishte

Pyjet trungishte artificiale me Pishë të Zezë në këtë Plan Mbarështrimi propozohen të jenë pyje prodhues dhe do të zbatohen punime Krasitje.

9.4.2. Masat silvikulturore në shkurre

Në këtë plan mbarështimi nuk janë planifikuar ndërhyrje silvikulturore në shkurre.

9.4.3. Pyllëzimi, ripyllëzimi

Në këtë plan mbarështimi nuk janë planifikuar pyllëzime.
Duke shprehur edhe mendimin e komunitetit gjatë zbatimit të këtij plani mbarështrimi vëmëndja e duhur duhet t'i kushtohet edhe rigjenerimit natyral me farë në pyjet me Pishë të zezë të krijuara artificialisht në këtë ekonomi pyjore.

9.4.4. Gjëndja dhe masat në infrastrukturën e ekonomisë pyjore

Ekonomia pyjore "Brinjat e Kreshtës" është e përshkuar me rrugë pothuajse në të gjithë sipërfaqen e saj. Në përgjithësi gjëndja e rrugëve nuk është e mirë, sepse ndërtimi i tyre nuk është bërë konform kushteve teknike përkatëse, por edhe për shkak të kushteve atmosferike që i kanë dëmtuar

dhe sidomos për shkak të mungesës për një kohe të gjatë, të fondeve të nevojshme për riparimin dhe sidomos për mirëmbajtjen e tyre. Ato nuk i plotësojnë tërësisht kërkesat teknike, sepse nuk kanë gjerësine e duhur, mungojnë bankinat, kanalet dhe tombinot si dhe në jo pak raste kanë pjerrësi shumë të mëdha. Një pjesë e rrugëve të ndërtuara para viteve '90, janë degraduar pothuajse tërësisht dhe kanë mbetur vetëm si gjurmë.

9.4.5. Masat specifike për aktivitetet rekreacionale dhe didaktike

Nuk janë parashikuar masa për aktivitetet rekreacinale dhe didaktike.

10. PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I ZJARREVE NË PEIZAZH

10.1Analiza e rriskut nga zjarret në territorin e ekonomisë

Bazuar në analizën e gjendjes ekzistuese të Ekonomisë Pyjore Brinjat e Kreshtës, rezulton se rreziku nga zjarret përbën një nga faktorët më të rëndësishëm të fondit pyjor dhe kullosor në këtë territor. Për shkak të karakteristikave natyrore të relievit konfiguracioni, përbërja e vegjetacionit, kushteve klimatike dhe ndikimit antropogjen, territori i kësaj ekonomie paraqet ndjeshmëri të konsiderueshme ndaj zjarreve, kryesisht gjatë periudhës së verës dhe muajve me temperatura të larta dhe mungesë reshjesh. Ekonomia Pyjore Brinjat e Kreshtës shtrihet në një territor me reliev kryesisht kodrinor, me pjerrësi pak të theksuar dhe me ekspozime të ndryshme ndaj rrezatimit diellor, duke krijuar kushte të favorshme për tharjen e vegjetacionit gjatë sezonit të thatë. Në pjesë të konsiderueshme të territorit dominojnë formacionet pyjore cungishte, shkurret me lloje frashër, shqopë dhe pjesëmarrje të llojeve bashkëshoqëruese dhe sipërfaqe kullosore me bimësi të dendur barishtore, të cilat gjatë stinës së verës krijojnë ngarkesë të lartë djegëse. Gjithashtu, mungesa e ndërhyrjeve të vazhdueshme silvikulturore ndër vite, akumulimi i materialit organik lëgushor të thatë në sipërfaqe, si dhe prania e mbetjeve drusore të krijuara nga proceset natyrore të tharjes apo ndikimet antropogjene me kërkesat e vazhdueshme për material drusor duke vlerësuar dhe rimarrë vetëm asortimentet e vlefshme si dhe mbetjet nga humbjet gjatë shfrytëzimeve të pakontrolluara, rrisin ndjeshëm potencialin për ndezje dhe përhapje të zjarreve. Nga analiza e inventarizimit në terren dhe përshkrimeve parcelare të kryera gjatë hartimit të planit të mbarështimit, janë identifikuar si zona me risk më të lartë ndaj zjarreve ngastrat sipas tabelës së mëposhtme.

Nr	Ngastra	Sip në ha	Loji Pyjor	Forma e qeverisjes	Niveli i Riskut	Zona/Vendodhja
	LE08 00 039	60.6	Pishë e Zezë	Trungishte	I lartë	Kashnjet
1	LE08 00 068a	45.1	Pishë e Zezë	Trungishte	I lartë	Rras
2	LE08 00 069	50.4	Pishë e Zezë	Trungishte	I lartë	Rras
3	LE08 00 072	47.7	Pishë e Zezë	Trungishte	I lartë	Rras
	LE08 00 091a	69.5	Pishë e Zezë	Trungishte	I lartë	Zimaj
	LE08 00 097a	24.11	Pishë e Zezë	Trungishte	I lartë	Kalivaç
	LE08 00 097b	4.33	Pishë e Zezë	Trungishte	I lartë	Kalivaç

	LE08 00 098a	76.07	Pishë e Zezë	Trungishte	I lartë	Kalivaç
	LE08 00 099a	40.03	Pishë e Zezë	Trungishte	I lartë	Kalivaç
5	LE08 00 100	28.19	Pishë e Zezë	Trungishte	I lartë	Kalivaç
6	LE08 00 101	13.33	Pishë e Zezë	Trungishte	I lartë	Kalivaç
	LE08 00 102	49.21	Pishë e Zezë	Trungishte	I lartë	Kalivaç
	LE08 00 103	41.93	Pishë e Zezë	Trungishte	I lartë	Kalivaç
	LE08 00 104	72.82	Pishë e Zezë	Trungishte	I lartë	Kalivaç
	LE08 00 106a	21.7	Pishë e Zezë	Trungishte	I lartë	Kalivaç
Totale		***645.02***				

Ngastra karakterizohen nga dendësi relativisht e lartë e vegjetacionit me material të thatë organik. Pjerrësia e terrenit dhe ekspozimet e favorizojnë tharjen e shpejtë të mbulesës bimore gjatë periudhave me temperatura të larta. Një pjesë e këtyre sipërfaqeve ndodhen gjithashtu në afërsi të zonave rurale të banuara, rrugëve lokale dhe zonave të frekuentuara nga banorët, duke rritur mundësinë e ndezjeve nga faktorë njerëzorë. Kushtet klimatike të zonës ndikojnë drejtpërdrejtë në shtimin e riskut nga zjarret. Gjatë sezonit veror evidentohen periudha të gjata thatësire, temperatura të larta dhe ulje të lagështisë së ajrit dhe tokës, faktorë të cilët ndikojnë në tharjen progresive të vegjetacionit apo evapotranspirimit. Në këto kushte, edhe një burim i vogël ndezjeje mund të shkaktojë përhapje të shpejtë të flakëve, sidomos në terrenet me pjerrësi të madhe dhe në sipërfaqet ku mungon fragmentimi natyror i vegjetacionit. Një element tjetër me rëndësi në vlerësimin e riskut është edhe ndikimi antropogjen. Prania e qendrave të banuara në afërsi dhe brendësi të territorit të ekonomisë pyjore, përdorimi tradicional i kullotave, aktivitetet bujqësore dhe lëvizjet sezonale të banorëve krijojnë mundësi të konsiderueshme për zjarrvënie aksidentale apo të pakontrolluar. Në shumë raste, djegiet për pastrimin e kullotave, ndezja e zjarreve në ambiente të hapura apo pakujdesia gjatë aktiviteteve rekreative përbëjnë faktorët kryesorë të zjarreve me origjinë njerëzore. Pasojat e mundshme të zjarreve në territorin e EP Brinjat e Kreshtës konsiderohen me ndikim të lartë ekologjik, ekonomik dhe social. Zjarret mund të shkaktojnë degradim të mbulesës pyjore, dëmtim të regenerimit natyror, humbje të biodiversitetit dhe habitateve të faunës së egër, rritje të proceseve erozive dhe destabilizim të terreneve me pjerrësi të lartë. Gjithashtu, dëmtimi i sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ndikon drejtpërdrejt në uljen e funksioneve mbrojtëse të pyjeve, në përkeqësimin e peisazhit natyror dhe në reduktimin e kapaciteteve ekologjike të territorit për ruajtjen e ujërave, tokës dhe klimës lokale. Në aspektin ekonomik, zjarret mund të sjellin humbje të konsiderueshme të prodhimeve pyjore dhe kullosore, si dhe prodhimeve të dyta eterovajore duke ndikuar negativisht edhe në aktivitetet tradicionale të komunitetit lokal. Në funksion të uljes së riskut dhe mbrojtjes së fondit pyjor e kullosor, plani i mbarështimit parashikon marrjen e masave parandaluese dhe mbrojtëse në të gjithë territorin e ekonomisë, me fokus të veçantë në ngastrat me risk të lartë. Këto masa do të konsistojnë në nderhyrjet e propozuara në këtë plan mbarshimi si dhe nxirrjen e materialit drusor që do të rezultoj nga këto ndërhyrje të materialit , krijimin dhe mirëmbajtjen e brezave mbrojtës kundër zjarrit përgjatë rrugëve pyjore dhe pranë

zonave të banuara. Gjithashtu, do të synohet mirëmbajtja e rrjetit ekzistues të rrugëve pyjore për të garantuar akses të shpejtë të mjeteve zjarrfikëse dhe strukturave të emergjencës në rast zjarri.

TREGUES	TË DHËNA
Emri i Ekonomisë Pyjore	Ekonomia Pyjore Brinjat e Kreshtës
Bashkia	Lezhë
Sipërfaqja totale pyjore	3171.5
Sipërfaqja me risk të lartë zjarri	678.5ha
Lloji dominant i pyllit	Pisha e Zezë
Periudha e rrezikut të lartë	Qershor – Shtator
Autoriteti përgjegjës	Bashkia Lezhë – Sektori i Pyjeve

Në përfundim, mbrojtja nga zjarret në Ekonominë Pyjore "Brinjat e Kreshtës" konsiderohet një komponent themelor për garantimin e menaxhimit të qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor. Zbatimi i masave të propozuara në këtë plan mbarështimi do të ndikojë drejtpërdrejt në uljen e riskut nga zjarret, ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e tokës dhe burimeve natyrore, si dhe në forcimin e funksioneve ekologjike, ekonomike dhe sociale që pyjet dhe kullotat e kësaj ekonomie ofrojnë për komunitetin lokal dhe territorin e Bashkisë Lezhë.

11. VLERËSIMI EKONOMIK

11.1. Vlerësimi i efekteve të masave të planifikuara në pyje dhe kullota

Masat e propozuara dhe zbatimi i tyre në harkun kohor të këtij plani mbarështimi do të jenë garanci për rritjen cilësore dhe sasiore të grumbujve pyjorë sidomos për cungishtet të cilat detyrimisht kërkojnë kujdes të vazhdueshëm dhe punime përmirësuese për kalim në një stad të ri të zhvillimit të tyre. Po kështu propozimi për trungishtet si pyje prodhues në shprehje edhe të vullnetit të komunitetit do t'ju japë këtyre grumbujve pyjorë artificialë rëndësinë e duhur duke nxjerrë kështu në pah vështirësinë reale për instalimin e tyre.

Mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese dhe hapja e koridoreve në parcela të veçanta ku bimësia dhe vegjetacioni janë me dëndësi të madhe do jenë faktorë garantë për mbrojtjen sidomos nga zjarret, por do të jenë edhe faktorë nxitës të rritjes së frekuekuentimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha aspektet.

11.2. Planifikimi i të ardhurave/përfitimeve

Te ardhurat nga shitja e lëndës drusore janë llogaritur me tarifat në fuqi, sipas llojeve dhe kategorive dimensionale. Vëllimi i lëndës drusore që do të shitet, do të jetë ai që do të rezultojë nga punimet e përmirësimit.

Të ardhura të tjera janë planifikuar nga dhënia në përdorim e sipërfaqeve pyjore dhe jepen në tabelën nr.10.4.1;

Të ardhurat *tabela nr.10.4.1.*

Emërtimi	Njësia matjes	Sasia	Çmimi për njësi (leke)	Vlera (lekë)
Dru zjarri nga punimet e përmirësimit në cungishte	m3	9434	600	5,660,400
Të ardhura nga Përdorimi për fotovoltaikë(Inproduktive)	ha	314.88	143000	45,027,840
Të ardhura nga Përdorimi për eolike	ha	1.78	176000	313,280
Të ardhura nga Përdorimi për eolike	ha	0.64	143000	91,520
TOTALI				**51,093,040**

Të ardhurat në ekonominë e marrë në studim llogariten të jenë në total **51,093,040lekë.**

11.3. Planifikimi i kostove/shpenzimeve

Vlera totale e kostos së punimeve përmbledh të gjitha shpenzimet e punimeve të parashikuara, gjatë dhjetë viteve në harkun kohor të zbatimit të këtij Plani Mbarështimi, sipas urgjencës së parashikuar në kapitujt e mësipërm.

Kosto shpenzime *tabela 11.3.1*

Emërtimi	Njësia matjes	Sasia	Çmimi (lekë)	Vlera (lekë)
Përmirësim Cungishte në 1886ha	Ditë pune	53886	2841	153,090,126
Krasitje pyll pishe në 678.5ha	Ditë pune	7145	3182	22,735,390
Rrallime tipi I në 26.7 ha	Ditë pune	763	2841	2,167,683
Përmirësim kullote 437.8 ha	Ditë pune	5837	2841	16,582,917
TOTALI				**194,576,116**

11.4. Planifikimi i kostove/shpenzimeve

Mbi bazën e analizës së mësipërme, në tërësi rezultojnë më shumë të ardhura se sa shpenzime. Në këto shpenzime nuk janë përfshirë shpenzimet e tjera administrative që do të bëjë shërbimi pyjor, sepse është detyrë e tij, t'i përfshije ato, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Në total përfitimi bruto, për periudhën 10 vjeçare llogaritet në total në:

45,027,840 x 10 vite = 450,278,400

313,280 x 10 vite = 3,132,800

91,520 x 10 vite = 915,200
Dru zjarri 5,660,400 (për 10 vite)
Sipas tabelës nr.10.4.1;

Analiza kosto - përfitim *tabela nr.10.4.1.*

Emertimi	Vlera (lekë)
Të ardhura	459,986,800
Shpenzime	**194,576,116**
Përfitimi	**265,410,684**

Nga sa më sipër rezulton se nga aktivitetet e planifikuara, përfitimet në aspektin mjedisor do të sigurojnë të ardhura të konsiderueshme të cilat natyrisht, në vlerë janë shumë herë më të mëdha se sa tregojnë shifrat, nëse përllogariten efektet e dobishme që sjell mjedisi i gjelbër, pyjet në jetën e komunitetit dhe më gjërë.

12. LIDHJA MIDIS PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE E KULLOTAVE DHE ALFIS

12.1. PROÇESI I VALIDIMIT TË PMPK NË ALFIS

Kur plani i mbarështimit është gati, konsulenti duhet të paraqesë PMPK për miratim dhe pranim. Miratimi i planit të ri të mbarështimit dhe futja ne ALFIS konsiston në këto proçese :

- korigjimi i të dhënave gjeo-hapsinore
- plotësimi dhe korigjimi i informacionit të përgjithshëm të atributeve

Kryesisht, funksionalitetet edituese duhet të garantojnë korrektësinë e të dhënave të futura në mënyrë që të shmangen gabimet sa më shumë të jetë e mundur. Gjatë përgatitjes së planit të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave mund të ketë mangësi në lidhjen logjike midis të dhënave për shkak të lënies jashtë të informacionit. Për shembull, në hartimin e planit të ri të mbarështimit, hapi i parë është plotësimi i bazës së të dhënave mbi gjëndjen e pyjeve dhe më pas të përcaktohen objektivat dhe ndërhyrjet në bazën e të dhënave të planit të mbarështimit. Hartuesi i planit të mbarështimit duhet të përcaktoj objektivat dhe ndërhyrjet për secilën nënparcelë pyjore dhe kjo duhet bërë një e nga një. Sistemi informacionit paraqet listën e pacelave dhe nëparcelave pa objektivat e përcaktuara.

12.2. MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Kërkesat bazë për miratimin e planit të mbarështimit janë:

- Kur të përfundojë hartimi i planit të mbarështimit, një përmbledhje ekzekutive duhet të përgatitet duke nxjerrë në pah karakterisitikat e tij si: objektivat e planit, treguesit e fondit pyjor

dhe kullosor, mundësinë vjetore të shfrytëzimit, ndërhyrjet silvikulturore dhe efektiviteti ekonomik i zbatimit te planit të mbarështimit si dhe pjesëmarrja e komunitetit lokal në hartimin e tij.

- Veçoritë kryesore të planit të mbarështimit duhet të shpjegohen dhe diskutohen me stafin e shërbimit pyjor të bashkisë dhe me aktorët e tjerë nëpërmjet një prezantimi në poëerpoint.
- Plani dërgohet në Ministrinë e Mjedisit për miratim i shoqëruar me letrën mbështetëse të hartuar nga Drejtoria e Pyjeve e Bashkisë.
- Një komision ngrihet nga ministria (1 përfaqësues nga MM, 1 përfaqësues nga AKP dhe 1 përfaqësues nga FSHP/UBT), për të kryer kontrollin cilësor të planit të mbarështimit dhe për të siguruar që cilësia e planit është e mirë dhe se plani është hartuar në përputhje me rregulloret, udhëzuesin si dhe respekton të drejtat e palëve të treta.

Miratimi final i planit të mbarështimit për pyjet publike dhe private bëhet nga Ministri i MM pas vlerësimit pozitiv të komisionit.

13. MONITORIMI I ZBATIMIT TË PMPK

ALFIS bën të mundur monitorimin vjetor të ndërhyrjeve që kryhen në perputhje me planin e mbarështimit si dhe rastet e ngjarjeve ekstreme si psh: zjarret në pyje, rrëshqitjet, përmbytjet ,që ndikojnë në gjëndjen e territorit dhe menaxhimin e planit. Monitorimi i zbatimit të PMPK do të bëhet sipas proçedurës së pritshme të futjes së informacionit në ALFIS për çdo ndërhyrje duke futur këto të dhëna: (i) tipi i masave; (ii) sipërfaqja ku është kryer ndërhyrja (si psh: gjatësia e rrjetit të ri rrugor); (iii) kostoja e ndërhyrjeve; (iv) kontraktori; (v) punësimi i grave dhe burrave (mundësia për të ndarë dhe për të menaxhuar ndërhyrjet e parashikuara në planin e mbarështimit duke respektuar pjesmarrjen gjinore sipas ligjit 9970/2008) duke siguruar edhe një informacion më të përditësuar. Në ALFIS do të futen të gjitha ngjarjet që do të ndodhin në territorin e ekonomisë pyjore si: zjarret në pyje, problemet fitosanitare, rrëshqitjet etj.

13.1. RISHIKIMI PERIODIK I ZBATIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Megjithëse progresi në zbatimin e aktiviteteve specifike është një nga problemet kyç në rastin e një plani mbarështimi, ky i fundit duhet të rishikohet në mënyrë të rregullt çdo vit si pjesë e proçesit të ruajties dhe kontrollit mbi qeverisjen e pyjeve. Është e dobishme të kryhet periodikisht një rishikim tërësor i planit të mbarështimit gjatë periudhës së vlefshmerisë së tij. Tendenca afat-shkurtër në progresin e zbatimit të planit të mbarështimit mund të kryhet pas një periudhe 2, 3 ose më shumë vitesh në varësi të subjektit dhe këto tendenca duhet të pasqyrohen gjatë zbatimit të planit të mbarështimit.

13.2. RISHIKIMI AFAT-MESËM I PLANIT TE MBARËSHTIMIT

Rishikimi i planit të mbarështimit ka për qëllim adaptimin me kushtet e reja, të krijuara gjatë zbatimit të tij. Për këtë arsye, hartimi planit të ri të mbarështimit, përfaqëson një rishikim të situatës në ekonominë pyjore, për të cilën ai hartohet.

Rishikimi në fund të periudhës 10 vjeçare, përmban një analizë të rezultateve të kësaj periudhe, pas zbatimit të planit të mbarështimit, që lidhen me:

- evidentimin dhe pasqyrimin e ndryshimeve për sa i përket përhapjes se vegjetacionit pyjor brenda dhe jashtë ngastrave, pra korigjimeve të nevojshme nëse vërehen ndryshime kufinjsh.
- evidentimin dhe pasqyrimin e ndryshimeve strukturore dhe fazave të zhvillimit të grumbujve.
- evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes fitosanitare të grumbujve.
- evidentimin dhe pasqyrimin e infrastrukturës rrugore të shtuar.
- percaktimin e objektivave të rinj, për periudhën pasardhëse.

13.3. RISHIKIMI FINAL I PLANIT TË MBARËSHTIMIT

Rishikimet brenda periudhës 10-vjeçar, bëhet në intervale të ndryshme, për të verifikuar:

- zbatimin e planit të shfrytëzimeve,
- parametrat dendrometikë të grumbujve, në sipërfaqe provë të përhershme,
- zbatimin e planeve të punimeve përmirësuese dhe punimeve të tjera,
- reflektimin e ndryshimeve të ndodhura në fondin pyjor.

Në fund të periudhës së vlefshmërise së planit të mbarështimit, kryesisht në vitin e fundit, një rishikim tërësor i aktiviteteve të planit duhet të kryhet. Rishikimi final i planit të mbarështimit duhet të kryhet në të njëjtën mënyrë si rishikimi afat-mesëm, por duke përfshirë të gjithe periudhën kohore të vlefshmërisë së planit të mbarështimit. Duhet të analizohet efektiviteti dhe performanca e planit të mbarështimit kundrejt objektivave të tij, plani i ndërhyrjeve në fillim dhe sa është zbatuar ai dhe cili ka qenë buxheti. Rishikimi final i planit do të krijojë një bazë shumë të mirë për planin tjetër të mbarështimit që duhet të hartohet për ekonominë pyjore.

14. PËRGATITJA E HARTAVE

14.1. HYRJE

14.2. HARTA E EKONOMISË PYJORE

14.3. HARTA E FUNKSIONEVE

14.4. HARTA E TIPEVE TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

14.4. HARTA E RRJETIT RRUGOR, INFRASTUKTURËS DHE ZONAVE TË DEGRADUARA

14.4. HARTA E NDËRHYRJEVE